



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4804 Prot.

Fushë-Arrëz, më 31 . 12 . 2024

V E N D I M

Nr. 67, datë 23.12.2024

P Ë R

**MIRATIMIN E PLANIT TË MBARËSHTIMIT TË EKONOMISË PYJORE "IBALLE-MEZI 1&2"
NË TERRITORIN ADMINISTRATIV TË BASHKISË FUSHË-ARRËZ"**

Bazuar në Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" ; Ligjit nr.57/2020 "Për Pyjet", neni nr.11, pika 2, germa b ; VKM-në nr.134 date 3.3.2021 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.433 datë 08.06.2016 të këshillit të ministrave "Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive" ; Manualin e Planeve të Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave 2019, miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me Nr.864 prot, datë 30.01.2019", Shkreses së Bashkisë Fushë-Arrëz Nr.1639 prot datë 17.05.2024 "Kërkesë për mbështetje teknike për hartimin e Planeve të Mbarshtimit të Pyjeve dhe Kullotave të Bashkisë Fushë-Arrëz" ; Shkreses së Fakultetit të Shkencave Pyjore (UBT) nr.378/1 prot datë 02.09.2024 "Përgjigje ndaj kërkeses së Bashkisë Fushë-Arrëz për mbështetje teknike për hartimin e Planeve të Mbarshtimit të Pyjeve dhe Kullotave" ; Marrveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet Universitetit Bujqësor të Tiranës (Nr.2534 prot datë 10.09.2024) dhe Bashkisë Fushë-Arrëz (Nr.2868 datë 10.09.2024); Këshilli Bashkiak Fushë-Arrëz, në mbledhjen e datës 23.12.2024, pasi shqytoi projekt vendimin me 11 këshilltarë të pranishëm,

V E N D O S I

1. Miratimin Planit të Mbarështimit të Ekonomisë Pyjore "Iballe-Mezi 1&2" për vijimin e procedurave për miratimin e tij nga Ministria e Mjedisit dhe Turizmit sipas Ligjit nr.57/2020 "Për Pyjet", neni nr.11, pika 2, germa b.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori Juridik dhe Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave pranë Bashkisë Fushë-Arrëz.

Miratuar me: 11 vota Pro 0 Vota Kundër 0 Vota Abstenim

Zbardhur më datë: 31/12 /2024.

Bashkëlidhur këtij Vendimi është relacioni shpjegues për hartimin e Planit të Mbarështimit të ekonomisë pyjore "Iballe-Mzi 1&2".


KRYETAR

Nikolin BARDHOKU



Adresa: Rruga Qendër, Bashkia Fushë-Arrëz

email: info@bashkiafushearrez.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

BASH	ËZ
Nr.	
Re	

Shkodër, më 23.01/2025

Lënda: Mbi VKB Fushe-Arrëz Nr.67, datë 23.12.2024.

KËSHILLIT TE BASHKISE FUSHE-ARREZ

Prefekti përcaktuar në dispozitat e ligjit Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", i ndryshuar, ligjit Nr.139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore" ndryshuar, neni 9 pika 1.2, germa a dhe c, neni 27 pika 5, neni 54/k, neni 55/3, neni 64 germa c, Urdhërit të Kryeministrit Nr.50, datë 12.04.2017 "Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut", Urdhërit të MB nr.175, datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brëndshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I, "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", të nenit 11 pika 3, germa a, nenit 17 pika 1, germa "f" të Ligjit Nr.57/2020 "Për pyjet", VKM Nr.433 datë 8.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave dhe bashkive" të ndryshuar, pika 51, shtojca 49, ligjit Nr.111/2024 "Për disa ndryshime në ligjin Nr.9693 datë 19.03.2007 "Për fondin kullor" i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Mjedisit Nr.1 datë 9.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik", shqyrtoi dokumentacionin e dërguar nga Bashkia Fushe-Arrëz Nr.101/1prot datë 21.01.2025 "Kthim përgjigje shkresës nr.8/1 datë 13.01.2025", lidhur me VKB Fushe-Arrëz Nr.67 datë 23.12.2024: "Mbi miratimin e planit të mbarështimit të ekonomisë pyjore "Iballë-Mezi 1 & 2 në territorin administrativ të Bashkisë Fushe-Arrëz".

Pas analizimit të dokumentacionit në tërësi, Prefekti ju autorizon të procedoni.

Duke ju falënuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

Majlinda ANGONI



Bashkia Fushë-Arrëz – Ekonomia Pyjore Iballe-Mezi

**Plani i Mbarështrimit të Pyjeve dhe Kullotave për periudhën
2025 - 2034**



Bashkia Fushe-Arrez– Ekonomia Pyjore Iballe-Mezi

Plani i Mbarështrimit të Pyjeve dhe Kullotavepër periudhën 2025- 2034

Klient:	Bashkia Fushë-Arrëz
Burimi i financimit:	Marrëveshja e Bashkëpunimit UBT – Bashkia Fushë-Arrëz
Tipi i dokumentit:	Plani i Mbarështrimit të Pyjeve dhe Kullotave të ekonomisë pyjore Iballe-Mezi
Data e përgatitjes së draftit	13 Dhjetor 2024

Ekipi i Hartimit të Planit të Mbarështrimit Iballe-Mezi			
Ekspert kyç	Emër Mbiemër	Pozicioni	Firma
K-1	Elvin Toromani	Inxhinjer Pyjesh/FSHP	
K-2	Elson Salihaj	Ekspert privat GIS,	
K-3	Fran Gjoka	Agronom, ekspert i tokave dhe kullotave/FBM	
K-4	Nehat Collaku	Inxhinjer Pyjesh/FSHP	
K-5	Enea Malaj	Inxhinjer Pyjesh/FSHP	
K-6	Sokol Vata	Stafi i Pyjeve të Bashkisë Fushe-Arrez	
K-7	Pashuk Lulashi	Stafi i Pyjeve të Bashkisë Fushe	
K-8	Aleks Ndreka	Stafi i Pyjeve të Bashkisë Fushe	

Kodi ALFIS:

Data e miratimit:

SHKURTESA

PMPK	Plan i Mbarështrimit të Pyjeve dhe Kullotave
EP	Ekonomi Pyjore
PM	Plan Mbarështrimi
NjA	Njësi Administrative
SHPPK	Shoqata e Përdoruesve të Pyjeve dhe Kullotave
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AKP	Agjencia Kombëtare e Pyjeve

Përmbajtja

I.	Hyrje	8
I.1	Qëllimi dhe objektivat e Planit të Mbarështrimit të Pyjeve dhe Kullotave	8
I.2	Ecuria e punës dhe përgjegjësitë.....	8
I.3	Metodologjia e punës	8
I.4	Informacioni i përdorur në përgatitjen e PMPK.....	9
II.	Përshkrim i përgjithshëm i bashkisë dhe Ekonomisë Pyjore Iballe-Mezi.....	10
II.1	Informacion i përgjithshëm rreth Bashkisë dhe ekonomisë pyjore	10
II.2	Pronësia, administrimi dhe organizimi	10
II.3	Vendndodhja gjeografike dhe administrative.....	12
II.4	Historiku i mbarështrimit të pyjeve dhe kullotave në Ekonominë Pyjore	13
II.5	Situata demografike dhe socio-ekonomike	13
II.6	Gjuetia dhe peshkimi	14
II.7	Infrastruktura rekreative dhe didaktike.....	14
II.8	Prania e siteve dhe specieve me vlera të larta mbrojtjeje.....	14
III.	Situata aktuale e pyjeve dhe kullotave.....	14
III.1	Mbarështrimi dhe funksionet e pyjeve dhe kullotave.....	14
III.1.1	Përdorimi i territorit (aktual dhe propozimet)	14
III.1.2	Regjimi i qeverisjes (aktuale dhe propozimet)	15
III.1.3	Ndarja e Ekonomisë Pyjore në parcela dhe n/parcela	17
IV.	Përshkrimi i stacionit	17
IV.1	Klima	17
IV.2	Topografia dhe morfologjia.....	18
IV.3	Gjeologjia	19
IV.4	Tokat	19
IV.5	Rrjeti hidrologjik dhe burimet e furnizimit me ujë.....	23
IV.6	Erozioni në sipërfaqet e pjerrëta dhe rrjedhat ujore	23
IV.7	Rrëshqitjet e tokës.....	25
V.	Vegjetacioni dhe biodiversiteti.....	26
V.1	Brezat bio-klimatikë.....	26
V.2	Pyjet dhe kullotat	26
V.3	Tipet pyjore	27

V.4	Tipet e kullotave	29
V.5	Tipet e vegjetacionit potencial	29
V.6	Prania e vlerave të larta mbrojtëse	30
V.7	Rreziku për biodiversitetin dhe efektet mbi planifikimin	30
V.8	Mundësitë për aktivitete didaktike dhe kërkimore	30
VI.	Rrugët dhe infrastruktura	31
VI.1	Rrugët pyjore.....	31
VI.2	Struktura të tjera dhe përdorimet e tokës.....	32
VII.	Analizimi i të dhënave për pyjet dhe kullotat	32
VII.1	Analizimi i të dhënave për pyjet.....	32
VII.1.1	Analizimi i tipeve pyjore	32
VII.1.2	Ndarja e sipërfaqes dhe volumit sipas regjimit të qeverisjes.....	32
VII.1.3	Struktura e pyjeve sipas klasave të moshës dhe klasave të prodhimtarisë së stacionit.....	33
VII.2	Analizimi i të dhënave për kullotat.....	38
VII.2.1	Gjendja e kullotave	38
VII.2.2	Madhësia dhe vendodhja e sipërfaqes kullosore	38
VII.2.3	Altituda, pjerrësia, kundrejtimi dhe kushtet hidrologjike	39
VII.2.4	Mbërritshmëria.....	39
VII.2.5	Mbledhja e të dhënave për sipërfaqet e djegura në kullota	39
VIII.	Rezultatet e inventarizimit të pyjeve dhe kullotave	40
VIII.1	Rezultati i inventarizimit në pyje	40
VIII.1.1	Analiza statistikore e inventarizimit të pyjeve.....	40
VIII.1.2	Volumi në këmbë dhe rritja e grumbujve pyjorë.....	41
VIII.1.3	Struktura vertikale	42
VIII.1.4	Cilësia e lëndës drusore në këmbë	43
VIII.1.5	Biomasa dhe faktorët e ekspansionit të biomasës (FEB)	43
VIII.1.6	Analiza e rolit të ekonomisë pyjore në sekuestrimin e Karbonit.....	44
VIII.2	Gjendja shëndetësore/fitosanitare.....	45
VIII.2.1	Drurët e tharë	45
VIII.2.2	Dëmtime të tjera.....	45
VIII.3	Prerjet e paligjshme	45
VIII.4	Rezultatet e inventarizimit të kullotave	46

VIII.4.1	Tipi dhe cilësia e kullotave.....	46
VIII.4.2	. Përdoruesit e kullotave dhe koha e përdorimit.....	46
VIII.4.3	Numri aktual i blegtorisë	46
VIII.4.4	Përdorimi aktual dhe kapaciteti mbajtës i kafshëve.....	47
VIII.4.5	Infrastruktura aktuale	47
VIII.4.6	Problemet për kullotjen dhe furnizimin me bazë ushqimore për bagëtitë.....	48
IX.	Objektivat e planit të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave.....	48
IX.1	Objektivat e përgjithshme për planifikimin afatgjatë.....	48
IX.2	Objektivat kombëtare për zhvillimin e pyjeve dhe kullotave	49
IX.3	Përputhshmëria me Planifikimin Bashkiak dhe Rajonal	49
IX.4	Objektivat kryesore të PMPK	50
IX.5	Objektivat specifike për ekonominë pyjore	51
IX.5.1	Objektivat specifike për përdorimin e tokës, funksionin dhe regjimin qeverisës	51
IX.5.2	Objektivat specifike për tipet pyjore.....	51
IX.5.3	Objektivat specifike silvikulturore	52
IX.5.4	Objektivat specifike për kullotat.....	54
IX.5.5	Objektivat specifike për biodiversitetin	54
IX.5.6	Objektivat specifike për gjendjen shëndetësore	54
IX.5.7	Objektivat specifike për faunën e egër	55
IX.5.8	Objektivat specifike për pyjet me funksion prodhues	55
IX.5.9	Objektivat specifike për pyjet me funksion mbrojtës	56
IX.5.10	Objektivat specifike për pyjet me funksion rekreativ	56
IX.5.11	Objektivat specifike për pyjet me status mbrojtës	56
X.	Masat e planifikimit / aktivitetet në kuadër të PMPK.....	56
X.1	Mundësia vjetore e shfrytëzimit	56
X.2	Prerjet silvikulturore vjetore	58
X.3	Planifikimi vjetor i masave	58
X.3.1	Masat në pyje	58
X.3.2	Masat në kullota	58
X.3.3	Masat në infrastrukturë dhe në sipërfaqet e degraduara, rekreative dhe didaktike	59
X.4	Masat afatgjata	59
X.4.1	Masat silvikulturore në pyjet trungishte	59

X.4.2	Pyllëzimet dhe ripyllëzimet	59
X.4.3	Masat e planifikuara në kullota	67
X.4.4	Gjendja dhe masat në infrastrukturë	67
X.4.5	Masat specifike për aktivitetet rekreative dhe didaktike	67
XI.	Vlerësimi ekonomik.....	68
XI.1	Vlerësimi i ndikimeve të masave të planifikuara mbi pyjet dhe kullotat.....	68
XI.2	Planifikimi i të ardhurave / përfitimeve.....	68
XI.3	Planifikimi i shpenzimeve.....	69
XI.4	Analiza përfitim-shpenzime	69

I. Hyrje

I.1 Qëllimi dhe objektivat e Planit të Mbarështrimit të Pyjeve dhe Kullotave

Qëllimi kryesor i këtij Plani Mbarështrimit të Pyjeve dhe Kullotave (PMPK) është të zhvillojë mbarështrim të qëndrueshëm dhe shumëfunksional të pyjeve dhe kullotave bashkiak brenda kufijve të **Ekonomisë Pyjore (EP) Iballe-Mezi** për periudhën 2025 - 2034, duke balancuar aspektet ekonomike, sociale dhe ekologjike. Në këtë drejtim, ai synon të përcaktojë, përmes një qasjeje të integruar, pajtueshmërinë e ngushtë midis kufizimeve dhe mundësive për të vlerësuar burimet pyjore e kullosore dhe nevojat bashkiake dhe palëve të interesuara lokale për të maksimizuar përfitimet e tyre. Ndërkohë, qëllimi i ndjekur është krijimi i kushteve të përshtatshme për të rritur kapacitetin e stafit lokal dhe bashkiak për të zbatuar masat përmes një mirëkuptimi të ndërsjellë dhe duke rritur bashkërendimin dhe ndërveprimin.

I.2 Ecuria e punës dhe përgjegjësitë

Puna për hartimin e planit të mbarështrimit filloi me grumbullimin e dokumentave të nevojshëm për hartimin e planit të mbarështrimit si:

- planin e vjetër të mbarështrimit i vitit 1988, hartat e ekonomisë pyjore,
- dokumentat që lidhen me aspektin ligjor në fushën e pyjeve si: Ligji Nr. 57/2020, datë 30.04.2020 "Për pyjet";- Dokumenti i Politikave Pyjore në Shqipëri, 2019-2030 me VKM Nr. 814, datë 31.12.2018.

Eksperti GIS pasi ndertoi hartën pyjore të ngastrave dhe nengastrave pyjore, ndertoi rrjetin e sipërfaqeve prove i cili u pasqyrua në harte dhe në ortofoto dhe me pas pikat e këtij rrjeti u hodhën në GPS ku me pas filloi puna e terrenit e cila zgjati për një periudhë 3 mujore deri në fund të muajit Nëntor 2024.

Përgjegjësia për kryerjen e punimeve të terrenit dhe hartimin e planit të mbarështrimit ka qenë e stafit të bashkisë Fushe-Arrez në bashkëpunim me stafin e Fakultetit të Shkencave Pyjore. Stafi i bashkisë realizoi punimet e inventarizimit pas trajnimit 4 ditor në terren në bashkëpunim me stafin e Fakultetit të Pyjeve dhe me pas punuan në mënyrë të pavarur për të grumbulluar të dhënat. Skedat e terrenit të plotëuara nga stafi i bashkisë u përdorën për gjenerimin e të dhënave në nivel ekonomie pyjore nëpërmjet programit Access të përgatitur me mbështetjen e FAO-s. Pas përfundimit të matjeve në terren puna vazhdoi me përpunimin e të dhënave dhe me shkrimin e raportit të planit të mbarështrimit.

I.3 Metodologjia e punës

U zbatua një metodologji nëpërputhje të plotë me përshkrimet në **Udhëzuesin e Planeve të mbarështrimit të pyjeve dhe kullotave të vitit 2019**. Në fakt është thelbësore që të lidhet analiza e burimeve pyjore dhe kullosore me vizionin lokal të shprehur përmes takimeve me palët e interesuara. Qëllimi është gjetja e ekuilibrit të duhur midis kapaciteteve të burimeve pyjore-kullosore dhe

prishmërive të përdoruesve, në përputhje me rregulloret për një mbarështrim të qëndrueshëm dhe shumë funksional. Analiza e palëve të ndryshme të interesit për hartimin e planit të mbarështrimit jepet më poshtë:

Palët e interesit	Interesi	Aktivitetet
Banorët (me qëndrim të përhershëm, dhe përdoruesit e pyjeve)	-Mbrotjtja dhe zhvillimi i pyjeve -Sigurimi i të drejtave ligjore për përdorimin e pyjeve dhe kullotave	-Prodhimii druve të zjarrit, lëndës drusore për ndërtimin e shtëpive, mbledhja e frutave të pyllit & bimëve mjekësore dhe kullotja e bagëtive.
Vjelësit e produkteve pyjore jodrusore	-Rritja e të ardhurave familjare	- Vjelja e frutave të pyllit dhe bimëve mjekësore.
Bashkia	-Mbarështrim i qëndrueshëm dhe shumëfunksional i pyjeve në nivel lokal. -Zhvillimi, ruajtja dhe administrimi i fondit pyjor nëpronësi të Bashkisë.	-Hartimi, zbatimi dhe kontrolli i mbarëvajtjes së PM. -Përgatitja e projekteve për investimepër fondin pyjor të Bashkisë. -Ofrimi i mbështetjes teknike dhe këshillimore për pronarët, përdoruesit dhe shoqatat e pyjeve. -Bashkëpunimi me Shoqatat e Përdoruesve të Pyjeve dhe Kullotave dhe organizata të tjera të shoqërisë civile. -Garantimi i përfshirjes së komuniteteve lokale në administrimin dhe mbarështrimin e pyjeve dhe kullotave.
Bizneset e bazuara në prodhimet pyjore jodrusore	-Fuqizimi i zinxhirit të vlerës së prodhimeve pyjore jodrusore	-Kultivimi dhe grumbullimi i bimëve të ndryshme dhe bimëve mjekësore. -Eksportimi i bimëve.

I.4 Informacioni i përdorur në përgatitjen e PMPK

Krahas informacionit të mbledhur gjatë inventarizimit në terren dhe procesit pjesmarrës, informacioni specifik që ishte i domosdoshëm të sigurohej në nivelin e BashkisëFushe-Arreznë fillim të aktiviteteve ishte:

- Ndarjet parcelare dhe n/parcelare për EP Iballe-Meziduke bere rakordin e kadastrës dhe ALFIS;
- Te dhena demografike sipas fshatrave brenda territorit të ekonomise pyjore
- Studime të meparshme në këtë ekonomi pyjore
- Plani i Zhvillimit Vendor i BashkisëFushe-Arrez
- Aktivitete të lidhura me prodhimet drusore dhe jodrusore nga pyjet dhe kullotat;
- Rrugët dhe infrastruktura pyjore;
- Të dhëna historike mbi zjarret në pyje dhe rreziqet natyrore (rrëshqitjet e tokës, përmytjet, stuhitë, tharjet e drurëve);
- Rrjeti hidrologjik dhe burimet e furnizimit me ujë;

- Prania e aktiviteteve edukative dhe didaktike lidhur me pyjet dhe kullotat;
- Prania e aktiviteteve turistike lidhur me pyjet dhe kullotat;
- Prania e siteve me vlera të larta mbrojtjeje. Kjo përfshin rezervatet farore, habitatet e veçanta (liqene, pyje të brigjeve të lumenjve...), site të njohura për vlerat kulturore, peizazhe të mbrojtura.;
- Prania e aktiviteteve kërkimore në pyje dhe kullota.

II. Përshkrim i përgjithshëm i bashkisë dhe Ekonomisë Pyjore Iballe-Mezi

II.1 Informacion i përgjithshëm rreth Bashkisë dhe ekonomisë pyjore

Ekonomia pyjore “ Iballe – Mezi “ është krijuar si e tille duke u mbështetur ne kriteret e trajtimit te saj, si ekonomi e vecante me kufi natyrale te theksuar qarte . Nga ana jugore kufizohet me ekonomine pyjore “ Krab dhe Dardhe “ ndersa nga ana veriore me ekonomine pyjore “ Lumi I Berishes “ dhe “ Bregu i Liqenit” . I gjithë territor i ekonomise pyjore shtrihet ne dy bazene ujembledhes , ne bazenin e lumit te Bosetes (Iballe) e cila per kete arsye eshte ndare ne pjese ekonomike me vete dhe nga bazeni ujembledhes I lumit te Meziut (pjesa e dyte ekonomike). Territori i ekonomise shtrihet qe nga fshati Iballe (Perendim) dhe del ne Arst Mezi (Lindje) prej nga mer emrin ekonomia “ Iballe – Mezi “.

II.2 Pronësia, administrimi dhe organizimi

Pronësia dhe situata e përdoruesve në të shkuarën

Bashkia Fushe-Arrez ne territorin e saj perfshin nje sere kategorish te perdorimit te territorit te cilat ne menyre me te detajuarjepen ne figuren e meposhtme.




Figure 1. Kategorite e perdorimiteterritorit ne bashkine Fushe-Arrez

Nje vend te rendesishem ne kete bashki luajne pyjet dhe kullotat te cilat jane nje aset me rendesi per popullsine dhe per zhvillimin e turizmit. Bashkia Fushe-Arrez ka nje siperfaqe pyjore prej 54575.6 ha dhe 50543.2 ha jane zona me bimesi natyrore. Gjatë periudhës 1900 – 1944, pyjet dhe kullotat ishin kryesisht pronë e pronarëve të mëdhenj dhe pjesa e mbetur, e banorëve të fshatrave. Pyjet dhe kullotat e fshatrave përdoreshin individualisht, duke respektuar kufijtë dhe traditat e vjetra, ndërkohë fshatarët mund të hynin në pyjet privatë për kullotje të bagëtive ose për lëndë drusore në këmbim të taksës ose punës që do duhet të kryenin. Për periudhën 1945-1990 pyjet dhe kullotat e kesaj ekonomie pyjore

administroheshin nga shteti dhe përdorimi i tyre ishte i përbashkët dhe i kushtojë interesave të shtetit. Planet e mbarrështimit dhe të inventarizimit të pyjeve dhe kullotave hartoheshin nga stafet e Drejtorise së Sherbimit Pyjor Fushe-Arrez dhe miratoheshin nga Keshilli Teknik i kesaj drejtorie. Keto plane hartoheshin pa u këshilluar paraprakisht me komunitetet lokale. Pas kësaj periudhe, politikat pyjore dhe kullimore filluan të nxisin përfshirjen e komunitetit në vendimarrje dhe zbatimin e PMPK-ve. **Kjo rezultoi në një proces decentralizimi, ku Qeveria e transferoi pronësinë mbi pyjet dhe kullotat dhe përgjegjësitë lidhur me to tek njësitë e qeverisjes vendore.** Në lidhje me kuadrin ligjor, Ligji nr. 57/2020 "Per Pyjet", Kreu IV, neni 16.

- Bashkia zhvillon strukturën e saj menaxhuese, qeverisjen dhe mbrojtjen e fondit pyjor dhe kullor brenda kufijve territorial administrativë (neni 16, pika 3)
- Administrimi dhe zhvillimi i pyjeve lokalë ndërmerret nga Bashkia
- Përgatitja e planit të mbarrështimit për pyjet dhe kullotat i ngarkohet stafit të Bashkisë

Por, Bashkia Fushe-Arrez duhet të kete aftesi dhe të siguroje mjete të nevojshme për kontrollin e territorit të ekonomise **Iballe-Mezi**. Përdorimi i pyjeve dhe kullotave (shfrytëzimi i druve të zjarrit, kullotja, prodhimi i gjetit dhe bimëve mjekësore/frutave pyjore) duhet të planifikohet në menyre të drejte, si dhe të realizohet kontrolli i tyre burimeve pyjore dhe kullimore brenda EP Iballe-Mezi.

II.3 Vendndodhja gjeografike dhe administrative

Kjo ekonomi ka kufij natyral të dallueshem qarte të cilet në menyre më të detajuar jepen më poshte:

Ne veriperendim dhe në verilindje

Kufiri i ekonomise kalon nga maja e Arthotit në kuaotën 897.0 m vazhdon në kuaotën 887.0 m me kuaotën 904.0 m, me kuaotën 1011.0 m, kuaotën 1012 m me majën e Bosetes 1182 m me kuaotën 1293 m me livadhin e Zotnise me majën e Gurgac 1267 m, zbrit në kuaotën 1202 m, vazhdon me qafën e Hysen Markut, ngjitet në kuaotën 12040 m, në kuaotën 1275 m, ndjek kurrizin duke zbritur në kuaotën 1138 m, ngjitet në majën e Sukes Arsit 1250 m, zbrit në kuaotën 887 m ndjek kurrizin dhe përmes fshatit Arsit me fshatin Milisko, zbrit në liqenin e hidrocentralit "Drita e Partise" Fierze në kuaotën 300 m nivelin I liqenit

Kufiri jugor

Fillon me majën e Sukes së zeze në kuaotën 1227 m, zbrit në kurrizin e qafës Sharrit, ngjitet duke ndjekur kurrizin, shkon në majën e Shales së vogël në kuaotën 1325.1 m, shkon në kuaotën 1322.0 m, vazhdon në Lulkuq Shalë Madhe në kuaotën 1473.0 m, ngjitet në majën Kulle Gjodhise në kuaotën 1477.0 m, zbrit tek Qafa e Kryqit Ahmet Alisë, ngjitet në majën e Kunore Dardhes në kuaotën 1583.9 m, zbrit në qafën e Kronit të Shkout, ngjitet në majën e Laknishtes në kuaotën 1380 m, zbrit në qafën e Ujit në kuaotën 1068 m, ndjek kurrizin e Boko të Dardhes në kuaotën 1060 m, kuaotë të cilin kufiri i ekonomise mërr drejtimin VL duke zbritur në majën e Sukes Meziut në kuaotë 810 m, zbrit në kuaotën 643 m, në qendër të fshatit Mezi dhe duke ndjekur kurrizin zbrit në kuaotën 300 m nivelin I liqenit H / C "Drita e Partise".

Për pjesën e parë të ekonomise pyjore "Iballe" në periferi të saj ndodhet fshati I quajtur mërr të njëjtin emër "Iballe" (perendim) dhe për pjesën e dytë ekonomike "Mezi" (fshatrat Mezi dhe Arst) në

verilindje. Ne pjesen ekonomike “Mezi “ kalon rruga automobilistike e cila lidh Fushe-Arrezin me Fierzen dhe sherben per hapje rruges pyjore. Nga Kryqi i Ahmet Alise deri tek Kroni I Shkaut eshte hapur nje rruge per transportin e materialit drusor. Nga Qafa e Sharit jane future variantet e rrugeve pyjore ne 60 % te siperfaqes se pjeses ekonomike “Mezi“. Ne kufirin jugor kalon rruga kembesore “ Dardhe – Iballe”.

II.4 Historiku i mbarështimit të pyjeve dhe kullotave në Ekonominë Pyjore

Ky plan mbarështimi i pyjeve dhe kullotave është një domosdoshmeri pasi ka kaluar nje kohe e gjate dhe gjendja e burimeve pyjore dhe kullimore ka ndryshuar shume. Sipas planit te mbareshtimit te vitit 1988 siperfaqja e ekonomise pyjore Iballe-Mezi ishte 4028.95 ha dhe ndarja e siperfaqes se ekonomise pyjore ka qene si vijon :

Nr		Pj.ekonomikeIballe (ha)	Pj.ekonomikeMezi (ha)	EkonomiaPyjore Iballe – Mezi(ha)
A	SiperfaqePyjore	1278.7	2059.875	3338.575
1	Trungishte	640.325	1517.4	2157.725
2	Cungishte	638.375	490.725	1129.1
3	Shkurre	-	51.75	51.75
B	Siperfaqejopyjore	398	291.375	689.375
1	Siperfaqeinproduktive	122.75	154.875	277.625
2	Siperfaqezhveshur	49.0	19.25	68.25
3	Kullote	44.25	14.25	58.5
4	Tokebujqesore	182	103	285
	Shuma totale	1676.7	2351.25	4028.95

Situata aktuale e pyjeve në EP Iballe-Mezi nuk mund të konsiderohet si rezultat i një mbarështimi të qëndrueshëm dhe shumëfunksional, pasi presioni mbi burimet nuk mund t'i lejojë ata të ripërtërihen ose rimëkëmben në kushte të kënaqshme dhe po krijon një erozion të tokës në rritje. Përveç kësaj, prerjet e paligjshme, zjarret dhe presioni mbi burimet pyjore janë prezente ne kete ekonomi pyjore pasi banoret e kane jetesen te varur shume prej ketyre burimeve.

II.5 Situata demografike dhe socio-ekonomike

Bashkia Fushe-Arrez sipas Censurit ka nje popullsi prej 7405 banore me nje dendesi prej 13.7 banore/km², kurse sipas regjistrit te gjendjes civile rezulton te kete nje popullsi prej 11498 banore. Ne pergjithsi dendesia e popullsise eshte e ulet kjo per faktin se nje pjese e territorit eshte malor dhe mbizoterohet ne rreth 80% te saj nga pyjet. Te dhenat tregojne per nje largim te popullsise drejt qendrave te medha urbane dhe vetem gjate muajve te veres ka nje rritje te vogel te popullsise ku nje pjese e banorev kthene ne shtepite e tyre ose per shkak te turistev. Si rezultat i mundesise se ngritjes se agroturizmeve mendohet nje rritje e vogel e popullsise prej 10-15% dhe mendohet qe popullsi deri ne vitin 2030 te shkoj ne 130000 banore.

Tabela1. Popullsia e bashkise Fushe-Arrez sipas njësive administrative

Nr	Njesite Administrative	Popullsia sipas Censurit
1	Fushe-Arrez	2513
2	Blerim	913
3	Fjerze	1302
4	Iballe	1129
5	Qafe-Mali	1548
	TOTALI	7405

II.6 Gjuetia dhe peshkimi

Për shkak të moratoriumit aktual të gjuetisë së faunës së egër, gjuetia është një aktivitet i munguar dhe nuk gjeneron të ardhura. Territori i bashkise Fushe-Arrez strehon shumë lloje vertebroresh si peshq, shpend amfibe, reptile, gjitare, insekte etj. Kafshët karakteristike të zones janë ujku, dhelpra, lepuri, rreqebulli, ariu, mellenja, bilbili, harabeli. Vertebrorët janë përfaqësuar nga të gjitha grupet, si amfibet, zvarraniket, zogjtë dhe gjitarët. Reptilet përfaqësohen nga gjarprinjtë, hardhucat, breshka e zakonshme (*Testudo hermanni*), dhe zhapiku i Gjelbër Evropian (*Lacerta viridis*).

II.7 Infrastruktura rekreative dhe didaktike

Siç citohet shpesh në dokument kjo ekonomi pyjore ka një potencial të mirë për të zhvilluar aktivitete rekreative dhe turistike, veçanërisht lidhur me bukuritë natyrore të saj të cilat duhet të reklamohen dhe vizitohen nga turistët. Cilësia e peizazheve të ndryshme ofron mundësinë për të zhvilluar infrastrukturën dhe objektet turistike, bazuar në ato ekzistuese të pakta (shtigje, zona pikniku) dhe me qëllim zhvillimin e turizmit dhe ngritjen e hoteleve dhe restoranteve ku të gatohen produktet e kuzhines lokale.

II.8 Prania e siteve dhe specieve me vlera të larta mbrojtjeje

Në territorin e ekonomise pyjore nuk ka asnjë zonë të mbrojtur, por në territorin e bashkise Fushe-Arrez ka një sërë monumentesh natyrore dhe gjeologjike.

III. Situata aktuale e pyjeve dhe kullotave

III.1 Mbarështrimi dhe funksionet e pyjeve dhe kullotave

III.1.1 Përdorimi i territorit (aktual dhe propozimet)

Sipas planit të mbareshtrimit, përdorimi i territorit në EP Iballe-Mezi jepet në tabelën më poshtë.

Tab. Nr.3: PERDORIMI I TERITORIT

Kategorite e përdorimit të tokës	Sipërfaqja(ha)		%
	Aktuale	Propozuar	
Pyje	1577.2	1577.2	39.1%
Shkurre dhe/ose shoqërimi bimesie barishtore	1592.4	1592.4	39.5%
Sipërfaqe të hapura me pak ose pa vegetacion	601	601	14.9%
Kullota	14.5	14.5	0.4%
Miniera,sipërfaqe ndërtimi dhe vend grumbullime	246	246	6.1%
Sipërfaqe ujore	-	-	
Sipërfaqe të djegura	-	-	
Totali	4031.1	4031.1	


Brenda sipërfaqes së kësaj ekonomie pyjore ndodhen edhe toke buke e cila ka një sipërfaqe prej **37.3 ha**. Në nivel ekonomie pyjore sipërfaqja e përgjithshme është 4068.4 ha ku pjesën më të madhe e zënë pyjet dhe sipërfaqet me bimesi pyjore. Duhet të theksohet që burimet pyjore kanë qenë nën presion në të shkuarën me pasoja degradimi, erozioni të tokës dhe në prodhimtari. Si pasojë e emigrimit dhe një rënie të madhe demografike edhe numri i bagëtive, të cilat mbahen për nevojat vetjake të familjeve gjithashtu ka pësuar rënie në të njëjtin raport. Kjo shpie në një presion më të ulët mbi zonat pyjore. **Pra, nuk pritet dhe as rekomandohet të shihet një zvogëlim i përdorimit të tokës pyjore në të ardhmen.**

III.1.2 Regjimi i qeverisjes (aktuale dhe propozimet)

Në tabelën e mëposhtme jepet sipërfaqja pyjore sipas regjimit të qeverisjes referuar planit të mbareshtrimit aktual. Nga tabela shikojmë se në ekonominë pyjore Iballe-Mezidominojnë pyjettrungishte, me pas cungishtet.


Tab. Nr.4: FORMA E MENAXHIMIT

Forma e qeverisjes	Aktuale		E propozuar	
	Sipërfaqja	%	Sipërfaqja	%
<i>Ekonomia : Iballe-Mezi</i>				
Trungishte	961.4	61.0	961.4	61.0
Cungishte	615.8	39.0	615.8	39.0
Trung. e parregullt	0.0	0.0	0.0	0.0
Cung. e	0.0	0.0	0.0	0.0
Shkurre	0.0	0.0	0.0	0.0
Livadh	0.0	0.0	0.0	0.0
Kullote	0.0	0.0	0.0	0.0
Kullote me drure	0.0	0.0	0.0	0.0
Kullote me shkurre	0.0	0.0	0.0	0.0
Total:	1577.2		1577.2	



III.1.3 Ndarja e Ekonomisë Pyjore në parcela dhe n/parcela

Lista e të gjitha parcelave dhe n/parcelave me sipërfaqet përkatëse dhe përdorimin e tokës jepet në shtojcën 1. Pjesa ekonomike Iballe fillon me ngastren 1 dhe përfundon me ngastren 63, kurse pjesa ekonomike Mezi fillon me ngastren 1 dhe përfundon me ngastren 97. Me poshtë jepet harta e ndarjes parcelare të ekonomisë pyjore Iballe-Mezi.



IV. Pershkrimi i stacionit

IV.1 Klima

Elementet e klimes të marrë në kompleksitet të lidhur ngushtë me njëri – tjetrin luajnë rol të rëndësishëm në përhapjen dhe zhvillimin e bimesisë. Një dëshmi e kësaj është vendosja e bimesisë si në drejtim vertikal dhe horizontal. Vetitë fizike të ajrit ndikojnë në jetën e bimesisë. Një dëshmi e kësaj është vendosja e bimesisë si në drejtim vertikal dhe horizontal. Vetitë fizike të ajrit ndikojnë në jetën e bimesisë por edhe bimesia luan rolin e saj në elementet e klimes. Si rrjedhim midis klimes dhe bimesisë egziston lidhja e dyanshme (në të cilin ndikimin më të madh e ka klima mbi bimesinë sesa anasjelltas). Duke u

mbeshtetur ne harten kimaterike te Shqiperise ekonomia e marr ne studim ndodhet e zonen kontinentale mesdhetare lindore .

- Temperatura


Regjimi I temperatures ne ecurine e saj ditore dhe vjetore ndikon ne menyre vendimtare mbi aktivitetin bimor te ekonomise qe po studiojme . Karakteristikat teknike te llogaritura per lartesine 750 m jane temperatura mesatare vjetore 8.9 grade, temperature mes. e muajit me te ftohte – 0.3 grade , temperatura mes.e muajit me te ngrohte 17.7 grade , temperatura minimale vjetore 8,3 grade, temperatura max. vjetore 14 grade, temperatura minimale e muajit me te ftohte – 3.5 grade , temperature max e muajit me te ftohte eshte 3,2 grade, temperature minimale e muajit me te ngrohte eshte 11.3 grade, temperatura max e muajit me te ngrohte 24.4 grade, temperatura mes minimale shume vjecare absolute eshte 16.5 grade celsius.Temperatura max eshte 33,4 grade temperatura minimale eshte 24 grade. Muajt me temperature me te ulta jane dhjetori, janari, shkurti dhe marsi.Temperatura me e larte arrihet ne muajin korrik 30 grade . Sikurse temperaturat e ulta qe permendem me siper dhe temperaturat e larta nuk paraqesin ndikim keqprures per bimesine me perjashtim te temperaturave te larta te cilat mund te behen shkak per renie zjarri kryesisht ne llojin pishe.

- Reshjet

Reshjet atmosferike perbejne nje nga faktoret kryesor klimaterik ne lageshtiren e nje vendi e cila varet nga pozicioni gjeografik dhe vecorite e relievit, keto dy faktore kushtezojne sasine dhe intensitetin ne shperndarjen vjetore te reshjeve Sasia mesatare vjetore e reshjeve eshte 2336.8 mm. Muajt me te ngarkuar me reshje jane nga nentori deri ne mars. Reshjet e shiut kane shkaktuar pjesisht gerryerje ne pjesen ekonomike “ Iballe “ kryesisht ne anen e Gojonit. Kurse ne pjesen ekonomike “ Mezi “ ndikimi I reshjeve te shiut ka qene me keqprures si ne pjesen nga Guraxhite edhe ne pjesen poshte fshatit Artst . Eshte e domosdoshme nderhyrja ne keto siperfaqe per te sistemuar . Rendesi te vecante per bimesine kane edhe reshjet ne forme debore. Qendrimi i shtreses se debore dhe shkrirja e ngadaleshme e saj jane faktor vendimtar per mbrojtjen e filizerise si dhe rregullin e regjimit uxor .

IV.2 Topografia dhe morfologjia

Duke iu referuar cdo pjese ekonomike rezulton se pjesa ekonomike “ iballe” ka lartesi mesatare mbi nivelin e detit 1000 -1100 m. Kuota minimale ndodhet ne fshatin Iballe 800m, ndersa kuota max ne majen e Shales vogel 1325.1 m. Pjesa ekonomike “ Mezi”, ka lartesi mesatare 950 – 1000 m. Kuota me e vogel eshte niveli I liqenit 300m ndersa kuotat me te larta jane maja e Kunores Dardhes 1583,9m, Kulla e Gjodhise 1477m . Shala e madhe me kuote 1473m dhe Qafa e Hysen Sarkut 1288 m. Ngastrat pyjore kane nje lartesi qe varion nga 401-600 m deri ne 1600 m mbi nivelin e detit.Perqindja me e madhe eshte nje klasat e altitudes 1001-1200 m dhe 801-1000 m mbi nivelin e detit.



Ekonomia e marre ne studim perbehet nga dy baza ujembledhese Iballe dhe Arse Mezi, te cilet respektivisht jane ndare dhe si pjese ekonomike me vete. Pjesa ekonomike Iballe me kunderejtim te pergjithshem perendimor eshte e perbere nga dy faqe te kunderejtuara njera ne jug (pjesa veriore) dhe tjetra ne veri (pjesa jugore). Keto faqe kane pjerresi qe leviz ne kufijte 25- 29 grade. Ujerat qe rrjedhin nga dy faqet mblidhen ne lumin e Bosetes. Ky bazen I ka kuotat me te larta nga lindja duke zbritur drejt fushes Iballe ne perendim. Pjesa ekonomike Mezi ka kunderejtim te pergjithshem lindor, ujrart e te ciles grumbullohen ne lumin e Meziut .Shpatet e pjese perendimore ne pergjithesi kane pjerresi 25 – 29 grade, ndersa brinjat e kurores dhe parcelat e Lankishtes shkojne 30 grade.

IV.3 Gjeologjia

Duke u mbështetur ne hartën gjeologjike te Shqipërisë rezulton se formacionet mbi te cilat jane vendosur masivet e ekonomise perbehen nga shkembjenj magnetik, nitruziv. Ky formacion ndryshon nga lindja ne perndim . Pjesa lindore (pjesa ekonomike Mezi) perbehet nga mikrodiorite, ndersa pjesa ekonomike Iballe perbehet nga formacione diopozospilite

IV.4 Tokat

Ekonomia pyjore “ Iballe – Mezi “ ka nje perhapje mjaft te gjere dhe verehet ndryshimi I tokes nga njeri vend ne tjetrin si ne drejtimin vertikal dhe ne rajonizimin e kulturave drunore qe rriten ne te. Tokat karakteristike te kesaj ekonomie jane tokat e murrme pyjore. Keto perbejne pjesen qendrore te ekonomise. Keto toka formohen mbi formacione diopozospilite ne Iballe dhe mikrodiorite ne Mezi . Profili ne pergjithesi eshte i shkrifet dhe shtohet pjesemarrja e gureve.

1- Pjesa ekonomike lballe

Tokat e murrme pyjore : Ky tip tokash shtrihet ne pjesen e mesme te ekonomise nga 900- 1500 m mbi nivelin e detit . Keto toka jane nga mesatarisht te thella deri ne te thella dhe te vendosura mbi formacion amnor, magnetik (serpentine). Ne pergjithesi jane toka te fresketa te cilat ne thellesi e nisin perqindjen e lageshtires me strukture kokrrizore te pershkruara mire nga sistemi uxor cili shkon deri ne thellesi. Legusha e cila shkon deri ne 3 cm thellesi shpesh eshte e padekompozuar mire. Skeleti me dimensione te ndryshme vihet re ne krejt profilin. Ne keto koka vegjeton ahu qe ka formuar nje shtrese legushe me te trashe se ne ato parcela ku ka pishe ose lis. Vihet re se kjo legushe eshte gjysme e dekompozuar ne te gjitha profilet. Tokat jane skeletike dhe persa l perket perberjes mekanike jane Sub Argjilore te Mesme.

Persa i perket analizave kimike :

- **Reaksioni** Jane toka me reaksion acid l cili nuk e kalon vleren 4.3 . Vihet re nje stabilizim midis vlerave te horizonteve nga njeri – tjetri .
- **Humusi** Per sa l peket humusit keto toka paraqiten te pasura jo vetem ne horizontin humor 0 -5 cm, por edhe ne thellesine 30 cm. Vlera e humusit l kalon 90 %
- **Azoti** Po ashtu edhe azoti arrin vlera shume te larta duke l percaktuar keto toka shume te pasura jo vetem ne siperfaqe, por edhe ne thellesi ku arrin 0.147%
- **Fosfori** Persa l perket fosforit jane te varfera dhe ky fenomen vihet re jo vetem ne keto tipe tokash por edhe ne ato te kafenjta malore.
- **Karbonatet** Ne fosfor edhe karbonatet kane vlera te pakonsiderueshme edhe si te tilla keto toka jane quajtur pa karbonate .

Tokat e kafenjta

Keto toka kapin pjesen perendimore dhe qendrore te pjeses ekonomike lballe si dhe pjesen qendrore dhe lindore te pjeses ekonomike Mezi . Ne keto teritore ndeshim toka te kafenjta me kripezim magnezian . Keto toka jane formuar ne kushtet e zones mesdhetare kontinentale karakteristike e te cilave eshte vera e thate dhe dimri me mbulesa bore te paqendrueshme. Gjate veres se nxehte keto toka ngrohen shume dhe cahen ne thellesi 30 cm , kane lageshtire duke ndodhur procese biokimike si rrjedhim argjilimi me l madh ndodh ne thellesi sesa ne siperfaqe. Gjate periudhes vjeshte – dimer keto toka ndodhen ne regjimin uxor te tipit shpelar deri ne thellesi . Veshja e ketyre siperfaqeve me bimesi eviton rezikshmerine e shpelarjes.

Perfaqesohen nga profile nr 1, 3, 4 . Jane te thella, te fresketa ,me strukture kokrrizore e cila ne thellesi shkon deri ne amnore . Vihet re se jane toka skeletike, por rrenjet e bimesise depertojne ne te, ne krejt thellesine e profilit duke paraqitur nje system rrenjor te dendur. Edhe keto legusha paraqitet gjysme e dekompozuar. Keto toka jane te formura mbi formacione magmatike serpentinite . Jane toka SAM, SAR. Lloji l cili ndodhet mbi keto toka eshte lisi dhe pisha e zeze .

Persa l perket analizave kimike :

- **Reaksioni** Eshte acid , por qe nuk ndryshon shume nga njeri horizont ne tjetrin . Vlerat shkojne deri ne 5,92 .
- **Humusi:** Jane toka shume te pasura me humus , horizontet humusore permbajne me teper se 10 % humus, por edhe horizontet ne vazhdim jane shume te pasura ne humus .
- **Azoti** respektivisht me humuset arrin vlera te larta duke l paraqitur keto toka ne pergjithesi te pasura ne azot

- **Fosfori** Si edhe ne tipin e tokave te murrme pyjore jane te varfera ne fosfor . Ne asnje rast nuk e kalon vleren kufi te vleresimit te tokes si mesatarisht te pasura ne fosfor.
- **Karbonatet** Po ashtu arrijne vlera te pakonsiderueshme duke l peraktuar keto toka si toka pa karbonate

2- Pjesa ekonomike Mezi

Edhe ne kete pjese ekonomike u studiuhan dy tipe tokash

- Te murrme pyjore te perfaqesuara nga profili nr. 1, 2
- Toka te kafenjta malore te perfaqesuara nga profili nr 3,4

Toka te murrme pyjore te vendosura mbi formacion amnor, magnetic, diabazik. Jane toka te thella pak a shume skeletike,, te fresketa, me structure kokrrizore, e cila ne thellesi shkon deri ne amnore. Ka nje system rrenjor te dendur te depertuar mire ne krejt profilin. *Persa l perkete legushes* ajo eshte e trashe deri ne 2 cm , por e dekompozuar mire. Jane toka SAL – SAM . *Persa l perkete vetive fizike* jane toka te pasura si ne humus ashtu edhe ne azot, por jane te varfera ne fosfor. *Persa l perkete reaaksionit* jane toka acide me nje aciditet te pandryshueshem nga horizonti ne horizont. *Karbonatet* arrijne vlera te pakonsiderueshme dhe si te tilla keto toka vleresohen si toka pa carbonate.

Tokat e kafenjta malore jane te vendosura mbi formacion amnor gelqeror . Keto toka jane nga mesatarisht te thella deri ne te thella me structure kokrrizore, toka me pak freski . persa l perket sistemit rrenjor ai eshte l perhapur ne krejt profilin. Jane toka Suba Argjilore Mesme – Sub Argjilore te Renda.

Sipas vetive kimike :

Reaksioni l ketyre tokave eshte acid dhe l padiferencueshem nga horizonti ne horizont. Me humus keto toka jane shume tepasura jo vetem horizonti siperfaqesor ,por edhe ai ne vazhdim. Po ashtu edhe ne azot jane toka te pasura duke arritur vlerat e azotit 0,213% (Prof. 4). Krejt ndryshe ndodh me fosforin i cili arrin vlera te ulta ne krejt ekonomine duke i quajtur keto toka te varfera ne fosfor.

Thellesia e tokave

Thellesia e tokave ne kete ekonomi eshte mjaft e ndjeshme. Tokat e murrme pyjore jane mesatarisht te thella, ne disa raste te thella pa perjashtuar te ceketa (shpatina, laknishte) .

Per tokat e kafenjta te pjeses ekonomike l balle themi se jane me thellesi mesatare deri ne te ceket (tokat e lballes dhe Arthati). Kurse tokat e kafenjta te pjeses ekonomike Mezi jane te ceketa deri shume te ceketa , kjo ka ardhur si rezultat l terrenit shume te pjerrret . Ne tokat e kafenjta jane instaluar kryesisht dushqet te cilat per shkak te sistemit rrenjor te fuqishem l jane pershtatur dhe vegjetojne.

Lageshtia

Shumica e tokave ne kete ekonomi jane te fresketa . Tokat e kafenjta I kemi me lageshti te ndryshme ne shumicen e rasteve te thata duke mos perjashtuar dhe ato te fresketa , duke pare ne teresi ekonomine e marr ne studim ndeshim edhe toka te lageshta te ndodhura kryesisht ne kundrejtimet veriore ose ne luginat ku ka burime uji te vazhdueshem.

Humusi dhe legusha

Ne te gjithë teritorin e ekonomise ndeshim legusha 1-3 cm dhe ne disa raste 4cm e perbere nga gjethe, hala ,degeza dhe mbeturina pyjore. Legusha eshte e padekompozua ose gjysme e dekompozuar pasi ne pyjet e pashfrytezuar hyn pak drite ne to. Legusha ka perhapje uniforme ne te gjithë siperfaqen e cdo parcele. Pjesa e tokave te kafenjta ka pak legushe dhe njekohesisht te transformuar ne humus mbasi eshte shkelur nga bagetia . Ne ato vende ku ka kullotje intensive humusi mungon. Te dhenat e profileve sipas tokave ne ekonomine pyjore Iballe-Mezi jepen ne tabelen 2.

Table 2. Te dhenat e perberejs se profileve te tokes ne ekonomine pyjore Iballe-Mezi (burimi: Plani mbareshtirimit 1988)

Horizontet	Fraksionet ne (%)					A.F	Emertimi
	1- 0.05	0.05-0.01	0.01-0.005 0.002	0.005-0	0.02-		
Profili nr1 Iballe							
0-2	50	27.2	7.2	7.0	8	22.8	SAL
2-12	49.2	20.8	6.8	10.8	12.4	30	SAM
12- 26	32.7	31.3	11.4	7.4	17.4	36	SAM
26- 84	32.1	29.9	12.4	6.2	19.4	38	“
Profili nr.2							
0-3	44.8	33.2	0.8	6	15.2	22	SAL
3-29	42	29.6	14.8	2.8	10.8	28.4	SAM
29-74	36.6	28.9	10.0	12.1	12.4	34.5	“
Profili nr. 3							
0-10	24	29.6	12.4	10.4	23.6	46.4	SAR
10-25	35.2	22.4	2.4	12.8	27.2	42.4	SAR
25-96	35.4	15.8	4.9	14.1	29.8	48.8	SAR
Profili nr.4							
0-14	60.8	11.6	8.4	12.4	6.8	27.6	SAM
14-98	60.4	14.8	12	0.4	12.4	24.8	“
98-115	59.9	8.7	12.9	7.2	11.3	31.4	“
Profili nr.1 Mezi							
0-3	63.2	14	6.8	4.8	11.2	22.8	SAL
3-22	51.6	18.4	6.8	1.6	21.6	30	SAM
22-65	35.2	23.6	8.4	10	22.8	41.2	SAR
65-112	33.3	32	7.2	13.1	24.4	44.7	SAR
Profili nr.2							
0-4	54.8	13.6	11.6	5.2	14.8	31.6	SAM

4-28	58.8	26	-	4.8	10.4	15.2	SAR
28-76	33.6	29.2	10	10	17.2	37.2	SAM
Profili nr. 3							
0-17	18	38.8	6.8	10.8	25.6	43.2	SAR
17-40	18.4	33.6	8.8	15.2	24	48	“
Profili nr.4							
0-14	11.6	74.8	3.6	1.6	8.4	13.6	SR
14-48	32.8	28	8	8.8	22.4	39.2	SAM
48-87	34.4	25.6	9.2	11.1	19.7	40.0	SAM



IV.5 Rrjeti hidrologjik dhe burimet e furnizimit me ujë


Nga pikepamja hidrologjike ekonomia pershkohet nga nje rrjet I dendur perrenjesh te cilet ne pjesen ekonomike lballle rrjedhin nga lindja ne perendim duke u grumbulluar ne lumin e Bosetes, I cili e fillon rrjedhen e tij nga lumi Brodoneshit (Mrizi I Mire). Ky lum furnizohet nga shume perrrenj e perroska sekondare qe rrjedhin nga shpatet veriore dhe jugore. Rrjeti hidrografik I pjeses ekonomike Mezi, paraqitet shume I dendur , me dege kryesore lumin e Meziut. Dege sekondare jane perroi I Kunores , I Xhovoroi dhe ai I Meziut. Keto degezime perrenjesh bashkohen ne afersi te fshatit Quke-Bone duke formuar keshtu lumin e Meziut. Pervet perrenjeve te siperme kjo pjese ekonomike pershkohet nga shume perrenj dhe perroska te cilat derdhen ne lumin Mezi dhe nga ketu perfundojne ne hidrocentralin e Fierzes. Drejtimi I pergjithshem I rrjedhjes se ujerave eshte perendim – lindje duke I dhene ekonomise kundrejtimit te pergjithshem lindor. Pjesa e poshteme e ketij bazeni ujembledhes e sidomos tek Guraxhitet parcelat (4a dhe 5a) paraqet rrezik gerryerje prandaj duhet sistemuar.

IV.6 Erozioni në sipërfaqet e pjerrëta dhe rrjedhat ujore

Nga vrojtimi ne terren konstatuam se erozioni nuk perben problem per ekonominë pyjore, por mbrojtja e tokës duhet te përfaqësoje një interes thelbësor. Dihet se erozioni pakëson sasinë e humusit organik dhe kufizon vetitë fizike dhe mekanike te tokes, duke çuar në një rënie të përgjithshme të pjellorisë së saj dhe duke ndikuar ne rritjen vjetore te pyjeve dhe kullotave. Faktikisht, reshjet e befta të shiut, shpesh në sasi të mëdha dhe me intensitet të lartë, shtrirja e formacioneve të buta sedimentare lehtësisht të gërryeshme dhe mbikullotja dhe degradimi i pyjeve gjenerojnë erozion aktiv dhe të thellë. Nuk ka te dhena ne lidhje me sasine e elementëve ushqyes qe largohen nga erozioni në këtë ekonomi pyjore. Një vëmendje e veçantë i duhet kushtuar rolit vendimtar të pjerrësisë në këtë fenomen. Shpatet me pjerrësi më pak se 5% janë më pak të rrezikuara nga erozioni, megjithatë për shpatet me pjerrësi 5-25% rreziku është mesatar dhe bëhet më i lartë kur pjerrësia është mbi 25%. Nga te dhenat e modelit digjital te lartesisë per EP lballle-Mezirezulton se ngastrat qe kane nje pjerresi >30% zene nje siperfaqe te konsiderueshme.Kjo situatë ka një ndikim madhor nëmbarrështrimin e pyjeve dhe kullotave për këtë plan. Roli parandalues që luan bimësia pyjore ekzistuese është i pari që sillet ndërmend. Kjo bimësi

zvogëlon forcën goditëse të pikave të shiut mbi sipërfaqen e tokës, ruan dhe ngadalëson rrjedhjen sipërfaqësore të ujit të shiut, duke krijuar kushtet për t'u përthithur nga toka, duke e pasuruar tokën me lëndë organike, shmangur erozionin dhe rritur pjellorinë e tokës.






IV.7 Rrëshqitjet e tokës

Në lidhje me kushtet e hasura, të cilat gjenerojnë një shkallë të lartë erozioni siç përshkruhet në pjesën IV.6, rrëshqitjet e tokës gjithashtu paraqesin një rrezik, veçanërisht kur janë në diskutim objekte të tilla si ndërtesa, rrugë, ura, diga dhe për aktivitetet që kryhen rregullisht nga banorët (tokat bujqësore). Në këtë aspekt, rrëshqitja e tokës është njëqështje e rëndësishme, por nuk kemi konstatuar raste në EP Iballe-Mezi. Problem mbetet erozioni ujqor ne fshatin Iballe dhe mendojme qe te dnertohe n rreth 38 prita me nje volum prej 1060 m³.

Ekonomia pyjore	Pjesa ekonomike	Ngastra	Numri pritave	Volumi(m ³)	Lloji I prites
Iballe-Mezi	Iballe	1c	5	150	Mur guri Ilac cemento
	Iballe	11a	4	180	Mur guri Ilac cemento
	Iballe	13c	3	105	Mur guri Ilac cemento
	Iballe	21a	3	45	Mur guri Ilac cemento
	Mezi	21b	5	125	Mur guri Ilac cemento
	Mezi	24d	2	44	Mur guri Ilac cemento
	Mezi	24a	4	84	Mur guri Ilac cemento

	Mezi	24b	4	92	Mur guri llac cemento
	Mezi	34b	3	75	Mur guri llac cemento
	Mezi	88b	5	160	Mur guri llac cemento
Totali			38	1060	



V. Vegjetacioni dhe biodiversiteti

V.1 Brezat bio-klimatikë


Ekonomia pyjore Iballe-Mezi për vetë pozicionin fiziko-gjeografik, dominohet nga Brezi I Dushqeve (zona fitoklimatike Castanetum) dhe Brez I Pyjeve Ilire te Ahut (Zona fitoklimatike Fagetum).

V.2 Pyjet dhe kullotat

Ndarja e përgjithshme ndërmjet pyjeve, shkurreve, kullotave dhe formave të tjera të përdorimit të tokës (sipërfaqe shkëmbore, djerrë, rrjeti hidrologjik, sipërfaqe ujore ...) në EP Iballe-Mezi paraqitet më poshtë.

	Pyje	Pyje	Kullota	Kullota	Tjetër	Tjetër
Sip. totale (ha)	(ha)	(%)	(ha)	(%)	(ha)	(%)
4068.4	1577.2	38.8%	14.5	0.4%	2576.7	60.9%

Nga matjet ne terren rezulton se 38.8 % e siperfaqes se ekonomise pyjore mbulohet nga pyjet, 0.4% nga kullotat dhe 61 % jane siperfaqe me bimesi pyjore, shkembore, inproduktive, djerr, bujqesore dhe urbane.



V.3 Tipet pyjore

Në shkallë ekonomie pyjore, tipet e pyjeve shpërndahen siç tregohen në figurën e mëposhtme.




Figure 2.Shperndarja e tipevetepyjeve ne ekonominepyjoreIballe-Mezi

Nga tabela e Accessit, shikojme se pyjet me Bunge zene 26% te siperfaqes, pyjet me Ah 18.8%, pyjet me Pishe te Zeze 18.8% dhe me pas renditen tipet e tjera te grumbujve pyjore.

Tab Nr.22: Tipet e grumbullit aktual sipas funksioneve/ perqindja ndaj totalit te siperfaqes

Tipi i Grumbullit	F u n k s i o n i									
	<u>Total</u>		<u>Prodhuës</u>		<u>Mbrojtes</u>		<u>Rekreacio</u>		<u>Konservim</u>	
	ha	I %	ha	I %	ha	I %	ha	I %	ha	I %
<i>Ekonomia pyjore : Iballe-Mezi</i>										
Pyje me bredh te bardhe	47.84	3.0	47.84	3.0	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Pyje bredhi te bardhe me ah	9.9	0.6	9.9	0.6	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Pyje me ah	295.92	18.8	295.92	18.8	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Pyje ahu me bredh te bardhe	75.92	4.8	75.92	4.8	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Pyje ahu me pishe te zeze	97.22	6.2	97.22	6.2	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Pyje me pishe te zeze	296.86	18.8	268.15	17.0	28.71	1.8	0	0.0	0	0.0
Pyje pishe te zeze me bredh	14.47	0.9	2.94	0.2	11.53	0.7	0	0.0	0	0.0
Pyje pishe te zeze me ah	44.44	2.8	44.44	2.8	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Pyje pishe te zeze me dushqe	29.15	1.8	25.57	1.6	3.58	0.2	0	0.0	0	0.0
Pyje me qarr	59.34	3.8	44.88	2.8	14.46	0.9	0	0.0	0	0.0
Pyje qarri me dushqe te tjere	14.39	0.9	7.18	0.5	7.21	0.5	0	0.0	0	0.0
Pyje me bunge te perzier me ah	49.64	3.1	49.64	3.1	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Pyje bunge me pishe te zeze	131.56	8.3	131.56	8.3	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Pyje me bunge	410.54	26.0	386.1	24.5	24.44	1.5	0	0.0	0	0.0
TOTALI I	1577.19	100.0	1487.2	94.3	89.93	5.7	0	0.0	0	0.0

V.4 Tipet e kullotave

Ne kete ekonomi pyjore kullotat verore dhe zene nje siperfaqe prej 14.5 ha.Por duhet theksuar se kullotja nuk realizohet vetem ne keto ngastra por edhe ne siperfaqet djerr (400.5 ha) apo ne siperfaqet me bimesi pyjore (1592.4 ha).

BASHKIA	EKONOMIA	NGASTRA	SIPERFAQJA(ha)	Forma e menaxhimit
Fushe-Arrez	Iballe-Mezi	5b	9.5	Kullote
Fushe-Arrez	Iballe-Mezi	68b	2.0	Kullote
Fushe-Arrez	Iballe-Mezi	41c	1.5	Kullote
Fushe-Arrez	Iballe-Mezi	67b	3.0	Kullote
Totali			14.5	

V.5 Tipet e vegjetacionit potencial

Bazuar në hartën e vegjetacionit potencial të Europës e cila përfshin edhe Shqipërinë tipet kryesore të vegjetacionit potencial rezultojnë se në këtë ekonomi pyjore dominojnë formacionet ahishte (28.5%) dhe formacionet pyjore të me Bunge (32.5%), kurse përqindjen më të vogël e zënë formacionet drunore të shpërndarë (0.9%). Të dhënat japën në tabelën e mëposhtme:

Tab Nr.13a: Tipet e vegjetacionit potencial sipas funksioneve/ perqindja ndaj totalit te siperfaqes pyjore

Tipi i	F u n k s i o n i									
	Total		Prodhues		Mbrojtes		Rekreacio		Konservim	
	ha	I %	ha	I %	ha	I %	ha	I %	ha	I %
<i>Ekonomia pyjore : Iballe-Mezi</i>										
Formacion pyjor ahu - bredhi i bardhe	81.59	5.2	81.59	5.2	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Formacion ahishtesh	450.23	28.5	450.23	28.5	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Formacion pyjor - Bredhi i Bardhe	47.84	3.0	47.84	3.0	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Formacione pyjore te Pinus nigra Arnold,subsp.Pallasiana	381.7	24.2	337.88	21.4	43.82	2.8	0	0.0	0	0.0
Formacion druresh te shparthit	14.46	0.9	0	0.0	14.46	0.9	0	0.0	0	0.0
Formacion pyjor. Quercus petraea	512.17	32.5	487.73	30.9	24.44	1.5	0	0.0	0	0.0
Formacioni dushkajash i Quercus pubescens Wild., Ulmus minor Miller	86.97	5.5	79.76	5.1	7.21	0.5	0	0.0	0	0.0
Formacione shkurre te Quercus ilex L. dhe Quercus coccifera L.	2.23	0.1	2.23	0.1	0	0.0	0	0.0	0	0.0
TOTALI I EKONOMISE	1577.19	100.0	1487.2	94.3	89.93	5.7	0	0.0	0	0.0

V.6 Prania e vlerave të larta mbrojtëse

Duke iu referuar listës të udhëzuesit të vitit 2018 në lidhje me vlerat e larta mbrojtëse (VLM) dhe krahas informacionit të raportuar mësipër (VLM rreth diversitetit të specieve), vëzhgimet nga sipërfaqet provëtreguan se nuk u ndeshen lloje me status mbrojtje.

V.7 Rreziku për biodiversitetin dhe efektet mbi planifikimin

Duke iu referuar të dhënave në përshkrimin e parcelave dhe nën parcelave, mund të përcaktohet statusi aktual i elementëve ekzistues të biodiversitetit dhe llojete kërcënimeve. Kështu, **një rrezik specifik për biodiversitetin u vlerësua të jenë: (i) zjarret, (ii) mbikullotja dhe (iii) prerjet ilegale.**

V.8 Mundësitë për aktivitete didaktike dhe kërkimore

Sipas planit të zhvillimit të bashkisë Fushe-Arrez, turizmi është një aktivitet i rëndësishëm për gjenerimin e të ardhurave. Duke qenë se EP Iballe-Mezindodhet rreth 30 km larg qytetit të Fushe-Arrezit, mundësia për të vlerësuar peizazhin spektakolar të ofruarduket e lartë. Po kështu zona ofron mundësi për ecje në natyrë. Më tej, **duhet të zhvillohen gjithashtu aktivitete rekreative dhe didaktike drejt komuniteteve lokale** për rritjen e ndërgjegjësimit të fshatarëve për të drejtat e tyre të përdoruesit, për përvetësimin e burimeve në një mënyrë më të qëndrueshme, për të krijuar ndërveprime të reja midis stafit bashkiak të pyjeve dhe palëve të interesuara lokale, si dhe për fillimin e programeve studimore për edukimin mjedisor.

VI. Rrugët dhe infrastruktura

VI.1 Rrugët pyjore

Nga vrojtimi ne terren brenda kufijve të EP Iballe-Mezi, funksionaliteti i rrjetit rrugor në përgjithësi dhe i rrugëve pyjore në veçanti është një faktor kyç që ka nevojë për t'u përmirësuar, lidhur si me mirëmbajtjen e tyre ashtu dhe mundësinë për të përmirësuar ato të ndërtuara në tokë natyrore (rrugë dheu) duke i shtruar me çakull ose ne rastin me te mire duke i asfaltuar ato.




Figure 3. Rrjeti rrugor ne ekonomine pyjore Iballe-Mezi

Në kontekstin e një tendence intensive të largimit të banorëve nga zonat rurale, ajo që është në rrezik është perspektiva për një zhvillim më të mirë të EP në lidhje me burimet e pyjeve dhe kullotave, por gjithashtu përtej aspekteve ekonomike të përgjithshme (bujqësi, turizëm) edhe atraksioni i përgjithshëm i EP Iballe-Mezi. Gjendja dhe mirëmbajtja e rrjetit të rrugëve pyjore nga fshati Iballe deri ne brendesi te ngastrave te ekonomise pyjore eshte e keqe dhe shpesh te degraduara nga reshjet per shkak te mungeses se kanaleve anesore kulluese apo tombinove. Nga ana tjetër rruget apo variantet pyjore ne brendesi te ngastrave thuhajse mungojne pasi edhe ato qe kane qene me pare per shkak se nuk jane mirembajtur tashme nuk jane te kalueshme.

VI.2 Struktura të tjera dhe përdorimet e tokës


Për të përfunduar përmbledhjen mbi strukturat e tjera dhe përdorimet e tokës, duket e dobishme të ilustrimet me pajisjet e vaditjes dhe furnizimit me ujë, duke pasur parasysh se nuk ka infrastrukture ose objekte shtesë të rëndësishme në lidhje me kullotat dhe pyjet.

VII. Analizimi i të dhënave për pyjet dhe kullotat

VII.1 Analizimi i të dhënave për pyjet

VII.1.1 Analizimi i tipeve pyjore

Pyjet luajnë një rol të rëndësishëm në nivel bashkie dhe japin kontributin kryesor në produktet drusore dhe jodrusore. Gjatë inventarizimit në terren kemi vërejtur se në rastin e grumbujve pyjorë rreth 48% kanë një kurordendesi të ulët (0.7-1.0), 25% kanë një kurordendesi mesatare (0.5-0.7) dhe 27.2% kanë kurordendesi (0.3-0.5).



VII.1.2 Ndarja e sipërfaqes dhe volumit sipas regjimit të qeverisjes

Një tjetër aspekt i studimit ka qenë ndarja e sipërfaqes pyjore dhe volumit sipas regjimit të qeverisjes. Ndarja e sipërfaqes pyjore dhe volumit siç kërkohet nga udhëzuesi paraqitet më poshtë për secilën formë qeverisje.

Regjimi i qeverisjes	Sipërfaqja (ha)	Volumi mesatar (m ³ /ha)	Volumi i përgjithshëm në këmbë (m ³)
Trungishte	961.4	98.9	95048.4
Cungishte	615.8	60.3	37127.6
Gjithsej	1577.2	83.8	132176


VII.1.3 Struktura e pyjeve sipas klasave të moshës dhe klasave të prodhimtarisë së stacionit

Struktura sipas klasave të moshës u përcaktua për secilën formë menaxhimi duke marrë në konsideratë sipërfaqen dhe volumin në këmbë. Në rastin e trungishteve sipërfaqja më e madhe dhe volumi më i madh është në klasën e moshës 61-80 vjeç (49699 m³), dhe më pak në klasën e moshës 21-40 vjeç (1848.7 m³).

Trungishte Prodhuese

Tab Nr.22/7a: Shpërndarja e sipërfaqes dhe vëllimit sipas klasave të moshës

<u>Lloji</u>	<u>Kl moshes</u>	<u>Sip ha</u>	<u>Volum</u>
	<u>%ndr</u>	<u>%vo</u>	<u>Totm3</u>
<i>Ekonomia Pyjore : Iballe-Mezi</i>			
21-40vjeç			
AH	0	21	768
BRB	0	6.3	185.4
PIZ	0	20.6	895.3
41-60vjeç			
AH	0	98.9	9087.5
BRB	0	55.1	4550.7
PIZ	0	255.3	24393.5
61-80vjeç			
AH	0	338.5	39798.3
BRB	0	42.6	3793.5
PIZ	0	64.2	6107.2
81-100vjeç			
AH	0	8.6	1362.9
BRB	0	6.4	41
Totali i ekonomisë :		917.5	90983.3



Ne rastin e trungishteve mbrojtese volumi me I madh eshte ne klasen e moshes 41-60 vjec(1045.8 m³) dhe me i vogel ne klasen e moshes 61-80 vjec (98.6 m³).



Trungishte Mbrojtese

Tab Nr.22/7b: Shperndarja e siperafes dhe vellimit sipas klasave te moshes



<u>Lloji</u>	<u>Kl moshes</u>	<u>Sip ha</u>	<u>Volum</u>
	<u>%ndr</u>	<u>%vo</u>	<u>Tot m³</u>
<i>Ekonomia Pyjore : Iballe-Mezi</i>			
21-40vjec			
BRB	0.0	0.6	22.5
PIZ	0.0	10.9	388.0
41-60vjec			
PIZ	0.0	17.2	2249.4
61-80vjec			
AH	0.0	0.2	12.6
PIZ	0.0	14.9	1392.6
Totali i ekonomise :		43.8	4065.1

Cungishte

Ne rastin e cungishteve siperafja me e madhe dhe volumi eshte ne klasen e moshes 21-30 vjec (22811.9 m³) dhe me i vogel ne klasen e moshes 11-20 vjec (6341.1 m³).




Ndersa ne rastin e cungishteve mbrojttese volumi me i madh eshte ne klasen e moshes 21-30 vjec (28882.3 m³) dhe me pak ne ate 11-20 vjec (6341.1 m³).




Ndersa ne rastin e cungishteve mbrojtese volumi me i madh eshte ne klasen e moshes 11-20 vjec (1386.5 m³) dhe me pak ne ate 21-30 vjec (517.8 m³).

Ne lidhje me shperndarjen e siperfaqes dhe volumit sipas klasave te prodhimit rezultoi se pjesa me e madhe e siperfaqes dhe volumit ne kembe jane ne klasen e 4 dhe te 5-te te prodhimit. E njejta gje edhe per cungishtet dhe kjo tregon se keta grumbuj kane nje prodhimtari te ulet.

Trungishte prodhuese




Trungishte mbrojtese




Cungishte prodhuese

Nga paraqitja grafike rezulton se pjesa me e madhe e siperfaqes dhe volumit te cungishteve perfshihen ne klasat e 4 dhe te 5 te prodhimit.



Cungishte mbrojtese



VII.2 Analizimi i të dhënave për kullotat

VII.2.1 Gjendja e kullotave

Ne kete ekonomi sipërfaqja kullosore eshte 14.5 ha. Gjendja e kullotave eshte mesatare dhe ne to nuk jane kryer nderhyrje per rritjen e prodhimtarise prandaj nevoja per nderhyrje qe synojne te rritet prodhimtaria e tyre eshte e madhe. Po keshtu duke qene se nje pjese e sipërfaqes djerre dhe me bimesi pyjore perdoret per kullotje mendojme qe per te plotesuar nevojat e blegtorise per uje te pijshme te ndertojme 3 lera.

BASHKIA	EKONOMIA	NGASTRA	SIPERFAQJA(ha)	Prodhimtaria
Fushe-Arrez	Iballe-Mezi	5b	9.5	mesatare
Fushe-Arrez	Iballe-Mezi	68b	2.0	dobet
Fushe-Arrez	Iballe-Mezi	41c	1.5	mesatare
Fushe-Arrez	Iballe-Mezi	67b	3.0	mesatare
Totali			14.5	

VII.2.2 Madhësia dhe vendodhja e sipërfaqes kullosore

Saktësimet mbi sipërfaqen kullosore në parcela dhe n/parcela, vendndodhjen e tyre, jepen në tabelën vijuese.

BASHKIA	EKONOMIA	NGASTRA	SIPERFAQJA(ha)
Fushe-Arrez	Iballe-Mezi	5b	9.5
Fushe-Arrez	Iballe-Mezi	68b	2.0
Fushe-Arrez	Iballe-Mezi	41c	1.5

Fushe-Arrez	Iballe-Mezi	67b	3.0
Totali			14.5

VII.2.3 Altituda, pjerrësia, kundrejtimi dhe kushtet hidrologjike

Te dhenat per lartësinë mbi nivelin e detit dhe pjerrësinë në mënyrë të përgjithshme per parcelat që përdorensi kullote jepen ne tabelen e meposhtme.

BASHKIA	EKONOMIA	NGASTRA	SIPERFAQJA(ha)	Altituda	Pjerresia(grade)
Fushe-Arrez	Iballe-Mezi	5b	9.5	1100	18
Fushe-Arrez	Iballe-Mezi	68b	2.0	1050	23
Fushe-Arrez	Iballe-Mezi	41c	1.5	1150	20
Fushe-Arrez	Iballe-Mezi	67b	3.0	1250	21
Totali			14.5		

Nga tabela shikojme se kullotat vendosen ne nje lartesi nga 1050 deri 1250 m mbi nivelin e detit dhe nje pjerresi nga 18-23 grade.

VII.2.4 Mbërritshmëria

Sipërfaqja kullosore ka nje mbritshmeri te mire.

VII.2.5 Mbledhja e të dhënave për sipërfaqet e djegura në kullota

Ne kete ekonomi kemi konstatuar raste te demtimeve nga zjarret e ndodhura shume vite me pare.Te gjitha siperfaqet me bimesi pyjore me pare kane qene siperfaqe pyjore dhe me pas jane shfrytezuar dhe djegur nga zjarret duke mos patur mundesi rigjenerimi ne menyre natyrale.

VIII. Rezultatet e inventarizimit të pyjeve dhe kullotave

VIII.1 Rezultati i inventarizimit në pyje

VIII.1.1 Analiza statistikore e inventarizimit të pyjeve

Inventarizimi i EP Iballe-Mezizgjati 3 muaj dhe perfundoi ne Nentor 2024. Ai u bazua në matjet e sipërfaqeve provë të përhershme dhe të përkohshme te vendosura sipas nje rrjeti te baraslarguar sistematik për shkak se ka avantazhe jo vetëm në aspektin e saktësisë, por gjithashtu në vlerësimin e ndryshimit të të dhënave në pyje nëpërmjet krahasimit midis inventarizimeve të njëpasnjëshëm. Gjithsej u matën 1007 sipërfaqe provë, ku 536 sip proverane në pyje (cungishte, cungishte e perbere, trungishte & trungishte e perbere) dhe 12 siperfaqe prove ranenë sipërfaqe kullote.

Përdorimi i tokës	Nr. i sipërfaqeve provë
Pyll	536
Kullotë	12
Sipërfaqe jo pyjore	459
E pambërritshme	-
Gjithsej	1007

Inventarizimi i pyjeve u krye në ndërthurje me ortofotot me rezolucion të lartë si një mjet për ndërtimin e rrjetit dhe shpërndarjes së sipërfaqeve provë. Përveç kësaj, vendndodhjet e sipërfaqeve provë u përcaktuan gjithashtu edhe në hartat topografike, të cilat së bashku me ortofotot u përdorën nga ekipet e terrenit për të kompletuar inventarizimin. Metodologjia e përdorur për ngritjen e rrjetit të sipërfaqeve provë ishte e njëjtë me atë të specifikuar në Udhëzuesin e PMPK të vitit 2019. Matjet u kryen në tre rrrathë bashkëqendrorë në sipërfaqet provë, me sipërfaqe 25 m², 200 m² dhe 400 m², në mënyrë që të përfshiheshin të gjitha kategoritë diametrike të drurëve (1.3 m nga toka) në grumbujt pyjorë. Në sipërfaqen provë 25 m² u mblodhën të dhëna për ripërtëritjen natyrore dhe u matën drurët, diametri bazimetrik i të cilëve ishte nga 2 cm deri 7.5 cm. Sipërfaqet provë me këtë madhësi, u përdorën gjithashtu edhe për inventarizimin e kullotave dhe në vlerësimin e prodhimeve pyjore jodrusore. Në sipërfaqen e dytë provë (200 m²) u matën drurët me diametër bazimetrik nga 7.51 cm deri 27.5 cm dhe në sipërfaqen e tretë provë (400 m²) u matën vetëm drurët me diametër më të madh se 27.5 cm. Për të vlerësuar saktësinë e inventarizimit të pyjeve bazuar në volumin e përlogaritur për secilën sipërfaqe provë, ne vlerësuaam parametrat e mëposhtëm:

- Shmangia standard e volumit ndërmjet sipërfaqeve provë;

$$S_x = \pm \sqrt{S_x^2}$$
$$S_x^2 = \frac{\sum_{i=1}^n x_i^2 - \frac{(\sum_{i=1}^n x_i)^2}{n}}{n-1}$$

- Koeficienti i variacionit të volumit ndërmjet sipërfaqeve provë;

$$S_{x\%} = \frac{S_x}{\bar{x}} \cdot 100$$

- Gabimi standard në metër kub dhe përqindje;

$$S_{\bar{x}} = \frac{S_x}{\sqrt{n}}$$

Bazuar në këto ekuacione ne vlerësuam saktësinë e volumit ndërmjet sipërfaqeve provë dhe gjetëm që gabimi standard në llogaritjen e volumit ndryshon sipas shtresave dhe referuar tabelës se mëposhtme shkon nga 1.9% deri në 42.6%.

inventar2

10/01/2025 20:47:28

Analiza Statistike (Propabiliteti 68%)

Login

Shtresa (Tipi grum.+kl.moshes)	nr.sip prove	dev.standart	m3/ha (mesatare)	dev.standart ne %	gabimi standart	gab.standart ne %
C-HDAPN032	1		2672.9			
C-HDGGPP33	1		2693.9			
C-HDGGPP03	1		2672.9			
C-HDGGPP32	1		2776.6			
C-HDGGPP33	2	328.5	3178.9	10.1	228.6	7.1
CCCGQPP14	1		1549.0			
CCCDAPN062	1		3465.5			
CCCDGQC02	3	132.0	2807.6	4.7	76.2	2.7
CCCDGQC05	5	1357.5	3803.8	35.7	687.1	18.0
CCCDGQC03	1		77.9			
CCCDGQPP03	1		2170.6			
CCCDGQPP13	1		21382.8			
CCCDGQPP14	1		2952.3			
CCCDGQR02	7	2372.2	5489.0	68.0	686.6	25.7
CCCDGQR03	7	5054.5	8931.4	56.6	1910.4	21.4
CCCTGQC002	1		2170.6			
CCCTGQR02	1		3465.5			
CCCTGQR03	1		2776.6			
H-CDAPF530	1		774.5			
H-CDAPF540	2	36.7	1362.4	2.7	25.9	1.9
H-CDAPN032	2	1137.5	1889.6	60.2	604.3	42.6
H-CDAPN042	1		1347.0			
H-CDAPN043	1		1356.4			
H-CDGGPP43	1		1356.4			
HHHDAAA30	1		3465.5			
HHHDAAA420	1		2776.6			

Per nje vleresim me propabilitet 95%, gabimi standart duhet anumuzuar me:
 2, nqs numri i sipërfaqeve prove eshte >9,
 2.5, nqs numri i sipërfaqeve prove eshte >=5 dhe <=9,
 3, nqs numri i sipërfaqeve prove eshte <5


Records: 1 of 55

VIII.1.2 Volumi në këmbë dhe rritja e grumbujve pyjorë

Rezultatet e inventarizimit të pyjeve treguan që sipërfaqja pyjore e EP Iballe-Mezi është **1577.2 ha**. Volumi në këmbë është **132176 m³**, ekuivalent me **83.8 m³/ha** dhe nje rritje ne volum prej **4328.13 m³/vit**.

Regjimi I qeverisjes	Sipërfaqja (ha)	Volumi mesatar (m ³ /ha)	Volumi i përgjithshëm në këmbë (m ³)	Rritja mesatare vjetore (m ³ /vit)
Trungishte	961.4	98.86	95048.4	2744.61
Cungishte	615.8	60.29	37127.6	1583.52
Gjithsej	1577.2	83.8	132176	4328.13

Krahas kësaj, vlerësuam volumin e asortimenteve për speciet kryesore që ekzistojnë të dhëna në pasqyrat e kubimit me seri lartësie. Nga vlerësimet rezultoi që lenda e holle janë asortimenti drusor kryesor dhe zënë 48 % të volumit në këmbë, kurse lenda e mesme është asortimenti drusor i dytë me një peshë prej 32 %. Shpërndarja e asortimenteve drusore tregon që nga burimet pyjore në EP Iballe-Mezi mund të prodhohen asortimente drusore me dimensione mesatare nga Ahu dhe Pisha e zeze dhe dru zjarri nga cungishtet dhe permirsimet pyjore në tungishtet me moshe të re.




VIII.1.3 Struktura vertikale

Bazuar në të dhënat e regjistruara nga ekipet e terrenit në vlerësuam shpërndarjen e strukturës vertikale sipas parcelave pyjore. Vërejtëm që në të gjitha sipërfaqet provë, grumbujt pyjorë kanë strukturë vertikale me 1 katë.

VIII.1.4 Cilësia e lëndës drusore në këmbë

Vlerësimi racional dhe kompleks i lëndës drusore kërkon njohuri të hollësishme të cilësisë së grumbujve pyjorë, jo vetëm në drejtim të volumit të përgjithshëm, por gjithashtu edhe në drejtim të vlerësimit të asortimenteve. Ky klasifikim është realizuar nga raporti i volumit të drurëve ekuivalentë me klasën e parë të cilësisë ndaj volumit të përgjithshëm. Kjo hipotezë vërtetohet kur kemi parasysh vetëm drurët e kategorisë së diametrave qendrorë, të cilët kanë peshën më të madhe në vëllimin e përgjithshëm të grumbujve pyjorë. Bazuar në raportin e volumit të lëndës së punimit ndaj volumit të përgjithshëm, duke iu referuar tabelës së mësipërme ne bëmë vlerësimin e përqindjes së secilit asortimenteve dhe rezultoi se ne nivel ekonomie pyjore volumi lende se punimit eshte 78% kur perqindjen me te madhe e ka lenda e holle (56%) dhe me pak lenda e trashe (2%).



VIII.1.5 Biomasa dhe faktorët e ekspansionit të biomasës (FEB)

Pyjet dhe shkurret në EP Iballe-Mezi luajnë një rol të rëndësishëm në sekuestrimin e karbonit. Për llogaritjen e biomasës mbitokësore ne përdorëm të dhënat e volumit të siguruara nga inventarizimi në terren dhe për t'i konvertuar në peshë të thatë përdorëm të dhënat e dendësisë nga Udhëzuesi i Panelit për Ndryshimet Klimatike (Panel for Climate Change) për speciet kryesore për secilin regjim qeverisje:

- Pishene detit për pyjet trungishte¹
- Lisin për pyjet cungishte²

¹<https://www.wood-database.com/maritime-pine/>

²<https://www.wood-database.com/turkey-oak/>

- Maren per shkurret

Përmbajtja e karbonit në peshën e thatë të biomasës u konsiderua 0.5. Konvertimi nga C në CO₂ u bë duke u bazuar në peshën molekulare (CO₂/C = 44/12 = 3.667). Për llogaritjen e biomasës mbitokësore përdorëm ekuacionin e mëposhtëm:

$$B_{mbt} = V_{total} \times D_d \times C_{ratio} \times BEF$$

ku: V_{total} – volumi i përgjithshëm për secilin regjim qeverisje

D_d – dendësia e peshës së thatë

C_{ratio} – përmbajtja e karbonit në biomasën e thatë (0.5)

BEF_Faktori i ekspansionit të biomasës

Nga llogaritjet rezultoi se ne raport me volumin ne kembe te llogaritur nga matjet ne terren, sasia e CO₂ te sekuestruar eshte **222507.2 ton**.

Regjimi i qeverisjes	Volumi (m ³)	Densiteti ne njesi peshe te thate (kg/m ³)	Pesha e thate (ton)	FEF	Biomasa mbitokesore (ton)	Pesha e C (ton)	Pesha e CO ₂ (ton)
Trungishte	95048.4	600	57029.04	1.47	83832.69	41916.34	153832.98
Cungishte	37127.6	720	26731.87	1.40	37424.62	18712.31	68674.18
Gjithsej	132176.0		83760.91		121257.31	60628.65	222507.16

VIII.1.6 Analiza e rolit të ekonomisë pyjore në sekuestrimin e Karbonit

EP Iballe-Mezi ka një sipërfaqe prej 4068.4 ha dhe pyjet luajnë një rol të rëndësishëm në sekuestrimin e karbonit. Bazuar në të dhënat nga inventarizimi i pyjeve, sasia e CO₂ të sekuestruar nga burimet pyjore në kete ekonomi rezultoi 222507.2 ton. Nëse marrim parasysh rritjen mesatare vjetore të pyjeve (**4328.1 m³/vit**), sasia e CO₂ që depozitohet çdo vit është **7371.1 ton**. Kjo sasi pritej të ishte më e lartë nëse burimet pyjore në EP Iballe-Mezi do mbarështroheshin në mënyrë të qëndrueshme. Të gjitha prerjet e paligjshme dhe lënda drusore e djegur nga zjarret në pyje konsiderohen si rrjedhje, prandaj për këto arsye CO₂ aktual i depozituar është më i ulët se sa kapaciteti depozitues natyral. Megjithatë kjo EP ka një sipërfaqe të vogël pyjesh, këto burime pyjore luajnë një rol të rëndësishëm në ekonominë lokale dhe ofrojnë shumë shërbime mjedisore, siç janë sekuestrimi i karbonit, qarkullimi i elementëve ushqyes, mbajtja e ujit, cilësia dhe strehimi i kafshëve, etj.

VIII.2 Gjendja shëndetësore/fitosanitare

Gjendja shëndetësore dhe fitosanitare e grumbujve pyjorë përgjithësisht vlerësohet të jetë e mirë. Në grumbujt pyjorë të kësaj ekonomie **nuk ka shenja të ndikimeve të patogjenëve, të cilët zvogëlojnë rritjen apo çojnë deri në zhdukjen në nivel të grumbujve pyjorë.** Gjithashtu theksohet që **nuk ka raste të tharjes së drurëve për shkak të ndryshimeve klimatike dhe përsëritjes së thatësirave, megjithëse grumbujt pyjorë do të ekspozohen veçanërisht në të ardhmen,** duke marrë në konsideratë kushtet specifike të EPIballe-Mezi, të karakterizuara nga njëndryshueshmëri e altitudës, kundrejtimit dhe klimës. Prandaj mund të thuhet që dëmet kryesore janë shkaktuar nga burime të tjera: mbikullotja, zjarret në pyje, prerjet e paligjshme.

VIII.2.1 Drurët e tharë

Kemi konstatuar disa drure të thara në këto ekonomitë pyjore.

VIII.2.2 Dëmtime të tjera

Duke iu referuar rubrikës “dëmtimet” lidhur me të dhënat e grumbulluara gjatë inventarizimit, të cilat janë të lidhura me ato të rubrikës “rreziku për biodiversitetin” (shih pjesën V.8 për saktësim), janë dhënë rezultate të përgjithshme. Më tepër dëmtimet në EPIballe-Mezi janë shkaktuar nga zjarret dhe nga prerjet ilegale. Si rezultat sipërfaqet pyjore janë shndërruar në sipërfaqe me bimesë pyjore duke zënë rreth **1592.4 ha** ose 39% të sipërfaqes së ekonomisë pyjore. Aktualisht në këto sipërfaqe me bimesë pyjore nuk janë kryer punime për rehabilitimin e tyre dhe përdoren edhe për kullotjen e bagetive.

Rastet e dëmeve nga zjarret janë të disa viteve më parë por ka raste edhe të 2 viteve më të fundit. Në rastet e djegies së pyjeve, **ndikimet mund të vënë në pikëpyetje kapacitetin e ekosistemit për të mbajtur veten në të ardhmen** në statusin e pyllit ose kullotës dhe ofrimin e shërbimeve shoqërisë (përfshirë shërbimet mjedisore dhe sociale dhe mbrojtjen ndaj rreziqeve natyrore në zonat malore).

Kjo është arsyeja se pse zhvillimi i funksionit mbrojtës të ekosistemeve pyjore dhe kullosore është një nga qëllimet kryesore të këtij plani mbarështrimi, në përputhje me objektivat e tjerë kryesorë, siç janë rritja e sasisë dhe cilësisë së kapitalit të lëndës drusore në pyje.

VIII.3 Prerjet e paligjshme

Siç është përmendur më sipër, prerjet e paligjshme janë prezente në mjaft ngastrasidomos në pjesën ekonomike Mezi. **Më tepër se sa prerjet e paligjshme, janë prerjet informale që zhvillohen në të gjithë ekonominë pyjore.** Në këtë mënyrë, secila familje për të plotësuar nevojat e saj për dru zjarri ose për gardhe, hunj etj presin një pjesë të materialit drusor në këto ngastrat pyjore. Në këtë mënyrë ata synojnë të presin drurët me dimensionet më të mëdha. **Në këto rrethana, ndërhyrjet e bashkërenduara më mirë**

ndërmjet stafit të shërbimit pyjor bashkiak dhe banorëve janë një faktor kyç për të zvogëluar shkatërrimin e shkaktuar nga këto prerje informale. Si përparësi, fshatarët duhet të instruktohen të rrallojnë pyllin në formën e një ndërhyrje silvikulturore të përshtatshme, duke hequr drurët e thatë, të nënshtruarit dhe të shtrembërit. Presioni mbi burimet pyjore duhet, gjithashtu, të përqëndrohet në përdorimin e materialit drusor që rezulton nga prerjet silvikulturore. **Prandaj është thelbësore që zbatimi i këtij plani mbarështrimi të pasohet nga një bashkërendim më i mirë ndërmjet aktorëve në bashki dhe nga një strategji specifike e zhvilluar për kontrollin e aktiviteteve të prerjeve në pyjeve.**

VIII.4 Rezultatet e inventarizimit të kullotave

VIII.4.1 Tipi dhe cilësia e kullotave

Ne EP Iballe-Mezi kullotat zene një sipërfaqe prej 14.5 ha dhe ato kulloten gjatë verës në periudhën nga muaji Maj deri në Tetor. Pra këto janë kullota verore dhe kanë një cilësi mesatare. Koha e kullotjes varet nga kushtet klimatike si: fillimi reshjeve të shiut, debora, sasia e barit në kullote etj.

VIII.4.2. Përdoruesit e kullotave dhe koha e përdorimit

Kullotat përdoren kryesisht gjatë verës, dhe përdoruesit janë banorë të fshatrave në afërsi të sipërfaqeve kullimore.

VIII.4.3 Numri aktual i blegtorisë

Shumica e kafshëve përfaqësohen nga të leshtat, të dhirtat dhe gjedhët, pasi është më e lehtë mbarështrimi i këtyre llojeve, duke qenë se njerëzit kryesorë që merren me blegtori janë të moshuarit. Si pasojë e emigrimit dhe një rënie të fortë demografike, numri i bagëtive, të cilat zakonisht vlerësohen të jenë për nevojat e banorëve ka pësuar rënie. Në sasi, numri aktual i bagëtive ditët e sotme vlerësohet të jete zvogëluar me rreth 50%. **Kjo rezulton në një ulje domethënëse të presionit të kullotjes mbi burimet pyjore, megjithëse ekuilibri ndërmjet numrit të bagëtive dhe kapacitetit mbajtës është ende larg për t'u arritur.**

Sipas të dhënave të literaturës së lëndës së kullotave që zhvillohet në Fakultetin e Shkencave Pyjore, kapaciteti mbajtës i kullotave verore në vendin tone është 3.7 krere dele/ha. Duke qenë se këto janë kullota mesatare, mesatarisht në 1 ha mbahen rreth 5 dhen, kurse në zonat djerr dhe me bimesi pyjore kapaciteti mbajtës është 1 dhen/ha. Në llogaritje si vlerë referencë janë përdorur:

- 1 lope konsumon bar afërsisht sa 6 krere dele
- 1 kale ose mushke konsumon bar afërsisht sa 7 krere dele
- 1 dhi konsumon bar afërsisht sa 3 krere dele
- 1 gomar konsumon bar afërsisht sa 4 krere dele.

VIII.4.4 Përdorimi aktual dhe kapaciteti mbajtës i kafshëve

Parimi i përdorur për ndarjen e kullotave midis përdoruesve është “çdo fshat brenda kufijve të tij”. Nepermjet matjeve ne secilen ngaster kullosore eshte llogaritur prodhimtaria e cila varion nga 20-25 kv/ha. Kapaciteti mbajtes i kullotes percaktohet ne varesi te numrit te krereve qe kullosin ne kullote gjate nje sezoni kullosor. Kapaciteti eshte llogaritur duke nxjerre prodhimtarine reale te barit per 1 ha kullote, me sasine e barit te nevojshem per nje kafshe gjate sezonit te kullotjes. Ajo eshte percaktuar me formulen:

$$K = \frac{P}{R \cdot D}$$

ku: P-prodhimtaria e kullotes ne kg/ha

R-racioni ditor i barit ne kg per 1 kafshe

D-periudha e zgjatjes se sezonit(kohes) se kullotjes ne dite

Kapaciteti shprehet me numer kafshesh per 1 ha.

Duke qenë se cilësia e sipërfaqeve kullosore është përgjithësisht e mirë, nga studimet e mëparshme supozohet që **kapaciteti mbajtës mesatar për 1 ha llogaritet të jetë 2 krere dele/ha. Ne total sipërfaqja e disponueshme per kullotje eshte 2007.4 ha dhe numri total i krereve qe kulloten eshte 1050 krere. Ne total numri i krereve qe kullosin ne per nje periudhe 5 mujore (Maj-Shtator) jepet ne tabelen e meposhtme:**

BASHKIA	EKONOMIA	NGASTRA	SIPERFAQJA (ha)	Prodhimtaria (kv/ha)	Kapaciteti mbajtes		
					Dele	Dhi	Lope
Fushe-Arrez	Iballe-Mezi	5b	8.50	20	20	7	3
Fushe-Arrez	Iballe-Mezi	68b	2.00	25	6	2	1
Fushe-Arrez	Iballe-Mezi	41c	1.00	23	3	1	0.5
Fushe-Arrez	Iballe-Mezi	67b	3.00	22	7	2	1
	Kullote		14.5		36	12	5.5
	Djerr		400.5		133	44	22
	Sip me bimesi pyjor		1592.4		531	177	89
	Totali 1		2007.4		700	233	116.5

VIII.4.5 Infrastruktura aktuale

Mungon infrastruktura e nevojshme per kullotat prandaj mendojme qe te ndertohen **3 lera** per plotesimin e kerkesave te blegtorise per uje.

VIII.4.6 Problemet për kullotjen dhe furnizimin me bazëushqimore për bagëtitë

Nga vërtetimi në terren rezultoi serezerua ushqimore në kullote është e vogël, që do të thotë një mbikullotje e përgjithshme në kullotat e kësaj ekonomie. Ky është një shpjegim i qënësishëm i rritjes së presionit blegtoral mbi burimet pyjore dhe mbi ripërtëritjen e tyre, pasi çobenjtë kërkojnë përfurnizim me bazë ushqimore shtesë për bagëtitë që e sigurojnë nga gjethi nëpërmjet krasitjes së degëve në mënyrë të pakontrolluar. Në zonat më të ndjeshme, masa parësore që duhet marrë është ndalimi i kullotjes nëpërmjet një kontrolli më të mirë të bagëtive ose edhe duke i rrethuar me gardhe, në mënyrë që vegjetacioni i degraduar dhe mbulesa pyjore të mund të ripërtërihet brenda 5 viteve.

Në territorin e ekonomisë pyjore ka shenja të mbikullotjes, degradimit në sipërfaqet me dushk, të cilat së bashku me prerjet dhe tokat e varfëra janë baza e degradimit të pyjeve. Zhveshja e tokës (heqja e mbulesës barishtore dhe pyjore) ka çuar në erodimin e sipërfaqes së saj.

IX. Objektivat e planit të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave

IX.1 Objektivat e përgjithshme për planifikimin afatgjatë

Konkluzionet kryesore të analizuara në seksionin e mëparshëm II.4 duhet të risillen edhe njëherë:

- Mbarështimi i mëparshëm i pyjeve dhe kullotave, ekziston vetëm për një pjesë të kësaj ekonomie prandaj nevojitet një rivlerësim i gjendjes së burimeve pyjore dhe kullimore ekzistuese.
- **Kullotja e pakontrolluar dhe e pabashkërenduar** ka pasur një ndikim negativ në rritjen e pyjeve dhe në disa pjesë, të ripërtëritjes së tyre.
- **Mungesa e investimeve në trajtimin silvikulturor** të pyjeve ka bërë që rritja e tyre të jetë e vogël dhe ato të jenë të kërcënuara nga zjarret.

Si rrjedhim i drejtpërdrejtë, objektivi i përgjithshëm për planifikimin afatgjatë për EP Iballe-Mezipërqëndrohet në tre përparësi madhore, të cilat janë parakushte vendimtare për të arritur një mbarështim të qëndrueshëm dhe shumëfunksional:

1. Rritja e fondit pyjor, në drejtim të sasisë (volumi mesatar për hektar) dhe cilësisë (lënda drusore e prodhuar në pyjet trungishte). Ky PMPK duhet të shënojë një pikë kthese dhe një ndarje të qartë nga tendencat e mbishfrytëzimit të së kaluarës. Qëllimi i ndjekur është gjithashtu përmirësimi i prodhimtarisë së pyjeve, si edhe i vlerës së përgjithshme të burimeve pyjore (produkteve drusore, sekuestrimit të karbonit, shtimit të biodiversitetit, mbrojtjes së tokës dhe pjellorisë së saj, përmirësimi i shëndetit dhe vitalitetit të ekosistemit).
2. Konsiderimi i funksionit mbrojtës ndaj tokës si faktor kryesor që duhet të zbatohet para çdo lloji ndërhyrje në pyje.

3. Zbatimi i praktikave të kullotjesracionale për t'u dhene mundesi per tu ripërtërirë dhe domosdoshmërinë për të ruajtur një mbulesë vegetacioni të mjaftueshme.

Si një kusht përfundimtar për sukses, arritja e këtyre objektivave kërkon domosdoshmërisht një kontroll dhe një bashkërendim më të mirëmidis stafit të pyjeve të bashkisë dhe palëve të interesuara lokale. Prandaj do të jetë e një rëndësie shumë të madhe t'i kushtohet vëmendja kryesore që, **procesi i zbatimit do të përfshijë të gjitha palët e interesuara, nga komunitetet lokale tek drejtuesit e pyjeve të bashkisë dhe përfaqësuesit e bashkisë, duke ndërvepruar ngushtësisht dhe respektuar rolet e ndërsjella. Kjo qartësisht përfshin një kontroll të rreptë mbi prerjet e paligjshme.**

IX.2 Objektivat kombëtare për zhvillimin e pyjeve dhe kullotave

Sikurse është shtjelluar në seksionet I.2 dhe II.2, ky PMPK u punua duke iu përmbajtur ngushtësisht rregullores dhe kuadrit politik kombëtar për mbarështrimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave, ndër të cilët: Reforma administrative, Ligji Nr. 57/2020, datë 30.04.2020 "Për pyjet"; Dokumenti i Politikave Pyjore në Shqipëri, 2019-2030 dhe VKM Nr. 814, datë 31.12.2018.

IX.3 Përputhshmëria me Planifikimin Bashkiak dhe Rajonal

Ky PMPK u hartua në përputhshmëri të plotë me planin e zhvillimit të bashkisë Fushe-Arrez. Ky plan mbarështrimi u zhvillua sipas parimit të transferimit të kompetencave dhe rritjes së ndërgjegjësimit midis aktorëve, pas një sërë takimesh me banorë, barinj, perfasques të stafit të pyjeve të bashkisë Fushe-Arrez. Si rrjedhim të dhenat e grumbulluara u integruan për të siguruar një mbarështrim të qëndrueshëm në përputhje me kërkesat e popullsisë lokale dhe pritshmëritë e tyre. **Qëllimi i përgjithshëm ishte përcaktimi i masave dhe ndërhyrjeve, duke ekuilibruar burimet pyjore dhe kullimore me pritshmëritë e komunitetit lokal.** Raporti i procesit të pjesëmarrjes ofron më shumë hollësi rreth metodologjisë dhe rezultateve. **Në këtë kuadër, mundësitë dhe sfidat e identifikuar gjatë takimeve me palët e interesuara lokale përmbledhen si më poshtë:**

Mundësitë	Sfidat
Turizmi (<i>orientimi i bizneseve lokale, prodhimi i një harte eko-pyjore, përdorimi i tokave djerrë</i>)	Prerje jo të rregullta dhe mbishfrytëzim (<i>mbrojtja e pyjeve nga prerjet ilegale; mbrojtja e pyjeve aluvionale</i>)
Bimët mjekësore (<i>Kultivimi dhe mbledhja e BM si një mundësi për rritjen e të ardhurave të familjeve rurale</i>)	Ndalimi i kullotjes në pyje (<i>kërkohet një planifikim më i mirë dhe ndërtimi i lërave</i>)
Ripërtëritja e pyjeve (<i>Përmes pastrimeve, rrallimeve, etj.</i>)	Zjarret (<i>rekomandohet marrja e masave parandaluese ndaj zjarreve dhe ngritja e grupeve të vërojtimit</i>)
E drejta e përdorimit bazuar tek tradita (<i>ligji i ri për pyjet pritjet të rregullojë me një VKM të drejtën e përdorimit të pyjeve për banorët me qëndrim të përhershëm në fshat</i>)	Njohja dhe siguri i të drejtës së përdorimit (<i>në varësi të fshatrave, pyjet zakonisht përdoren në bazë lagje ose familje</i>)
Mbrojtja e pyjeve nga komunitetet	Vëmendja ndaj pyjeve dhe kullotave (<i>pyjet dhe kullotat nuk janë</i>)

	<i>përparësi për pushtetin vendor)</i>
Promovimi i praktikave të mira (të mbrojtjes së pyjeve nga vet komunitetet lokale).	Lëvizjet demografike (migrimi dhe emigrimi i moshave të reja) Gjenerimi i të ardhurave nga pyjet (pyjet përdoren vetëm për mbijetesë) Mbështetja financiare (investimet në pyje mungojnë ose kanë qene te pakta)

Pritshmëritë më specifike të popullsisë lokale jepen ne tabelen e mëposhtme. Këto kanë një rëndësi parësore dhe duhet të merren me konsideratë në mënyrë të kujdesshme gjatë periudhës së zbatimit të këtij PMPK, me një qëllim të qartë për përmirësimin e bashkërendimit dhe ndërveprimeve midis të gjitha palëve të interesuara.

Problemet	Mundësitë	Rekomandimet për PMPK
• Demt看et nga zjarret, mbikullotja, prerjet etj	• Gjendja e pyjeve është përmirësuar. • Bimët mjekësore (aguliçe, salep, shtog, trëndafil i egër, lisra, etj.).	• Mbrojtja e pyjeve nga zjarret. • Kryerja e rrallimeve dhe pastrimeve. • Ndërtimi i lerave për bagëtitë.
• Braktisja e zonave rurale	• Banorët janë të interesuar për zhvillimin e pyjeve.	• Pyllëzime me lloje autoktone dhe geshtenje.

IX.4 Objektivat kryesore të PMPK

Qëllimi kryesor i këtij PMPK është të sigurojë një mbarështrim të qëndrueshëm dhe shumëfunksional të pyjeve dhe kullotave të Ekonomisë Pyjore Iballe-Mezi, duke balancuar aspektet ekonomike, sociale dhe ekologjike, duke promovuar bashkërendimin e ngushtë ndërmjet stafit të pyjeve, popullsisë lokale dhe përfaqësuesve lokalë. Kjo përfundimisht do të lejojë **optimizimin e përfitimeve socio-ekonomike të burimeve për palët e interesuara lokale sot dhe në të ardhmen.**

Në përputhje të plotë me objektivat e përgjithshme të përmendura në pjesën IX.1, qëllimet kryesore janë:

- Arritja e qëndrueshmërisë dhe shumëfunksionalitetit të pyjeve dhe kullotave në mënyrë që të përmirësohet cilësia e lëndës drusore të prodhuar, të mirëmbahet mbrojtja ndaj erozionit dhe rreziqeve natyrore, të ruhet biodiversiteti, të sigurohen të ardhura dhe burime sipas nevojave lokale, tëmbahet ekosistemi vital dhe në gjendje të mirë shëndetësore.
- Përmirësimi i rritjes natyrore të grumbujve pyjorë përmes ndërhyrjeve silvikulturore, duke synuar njëkohësisht balancim më të mirë midis klasave të moshës dhe rritje të volumit të materialit drusor dhe sekuestrimin të karbonit.
- Lejimi i ripërtëritjes së pyjeve me praktika të përshtatura me ato të kullotjes.
- Rimëkëmbja e mbulesës së degraduar të vegjetacionit nëpërmjet pyllëzimeve.
- Mirëmbajtja dhe përmirësimi i funksionalitetit të rrjetit rrugor.
- Rritja e ndërgjegjësimit dhe ndërtimi i kapaciteteve të banorëve për ndërhyrje të përshtatshme në pyje në përputhje me nevojat e tyre.

- Zbatimi i masave aktuale nëpërmjet veprimeve interaktive dhe të bashkërenduara që lidhen me palët e interesuara lokale dhe zhvillojnë ndjenjën e përgjegjshmërisë dhe kontrollit ndaj mbikullotjes dhe prerjeve të paligjshme.

IX.5 Objektivat specifike për ekonominë pyjore

Objektivi kryesor ishte hartimi i planit të mbarështrimit për ekonominë pyjore Iballe-Mezi, si pjesë e territorit të bashkisë Fushe-Arrez. Njohja e situatës reale të grumbujve pyjorë dhe planifikimi i masave për të siguruar vazhdimësinë dhe qëndrueshmërinë e tyre konsiderohet si një tjetër detyrë. Në kuadër të përgatitjes së planit të mbarështrimit, përparësitë e planifikimit u harmonizuan dhe u ndërthurën me ato të prodhimit të lëndës drusore dhe krijimit të rezervave të larmishme të biodiversitetit dhe rimëkëmbjes së sipërfaqeve të degraduara në mënyrë sa më natyrale. Ky plan do të sigurojë një ekuilibër midis vlerave natyrore – si biodiversiteti – dhe aspekteve ekonomike në mënyrë që të plotësojë nevojat e komuniteteve dhe të përmirësojë jetesën e tyre. Procesi pjesëmarrës dhe të drejtat gjinore kanë qenë shtyllat kryesore gjatë hartimit të këtij PMPK.

IX.5.1 Objektivat specifike për përdorimin e tokës, funksionin dhe regjimin qeverisës

Lidhur me përdorimin e tokës ne parashikojmë që në periudhën 10 vjeçare të zbatimit të këtij PMPK, sipërfaqet me bimësi pyjore, të ruhen dhe të përmirësohet gjendja e tyre në mënyrë që të kryejnë funksionin mbrojtës të tokës. Në zonë ka shumë raste të sipërfaqeve të djegura dhe të demtuara nga prerjet ilegale të cilat mendohet të ripërterihen nëpërmjet pyllëzimit me fare ose fidane. Në rastet e ngastrave të tjera propozojmë kryerjen e trajtimeve silvikulturore për përmirësimin e gjendjes së grumbujve pyjorë në territorin e kësaj ekonomie pyjore.

IX.5.2 Objektivat specifike për tipet pyjore

Objektivi specifik lidhur me tipet pyjore është ruajtja e përbërjes ekzistuese të specieve dhe përmes ndërhyrjeve të përmirësohet gjendja e grumbujve pyjorë. Një objektivi tjetër do të jetë zëvendësimi i grumbujve pyjorë të vjetër në moshë me grumbuj pyjorë të rinj dhe instalimi i filizërisë në parcelat pyjore që do të shfrytëzohen. Po kështu problem mbetet ripërteritja e sipërfaqeve që dikur kanë qenë me ah dhe pishe të zeza dhe që si rezultat i zjarreve janë kthyer në sipërfaqe me bimësi pyjore. Instalimi i grumbullit pyjor në rrugë natyrore është thuar se i pamundur për shkak të mbulesës së dendur të fierit apo barit prandaj duhet të ndërhyhet me pyllëzime.

Tab Nr.38: Tipet e grumbullit te propozuar sipas funksioneve/ perqindja ndaj totalit te siperfaqes

Tipi i Grumbullit	Funksioni											
	Total		Prodhues		Mbrojtes		Rekreacio		Konservim		Mbr+Prod	
	ha	I %	ha	I %	ha	I %	ha	I %	ha	I %	ha	I %
Ekonomia pyjore : Iballe-Mezi												
Pyje me bredh te bardhe	47.84	3.0	47.84	3.0	0	0.0	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Pyje me ah	349.7	22.2	349.7	22.2	0	0.0	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Pyje ahu me bredh te bardhe	114.27	7.2	114.27	7.2	0	0.0	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Pyje ahu me pishe te zeze	106.27	6.7	106.27	6.7	0	0.0	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Pyje me pishe te zeze	284.5	18.0	240.68	15.3	43.82	2.8	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Pyje pishe te zeze me bredh	2.94	0.2	2.94	0.2	0	0.0	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Pyje pishe te zeze me ah	45.52	2.9	45.52	2.9	0	0.0	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Pyje pishe te zeze me dushqe	10.32	0.7	10.32	0.7	0	0.0	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Pyje me qarr	31.49	2.0	31.49	2.0	0	0.0	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Pyje qarr me dushqe te tjere	7.21	0.5	0	0.0	7.21	0.5	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Pyje me qarr	14.46	0.9	0	0.0	14.46	0.9	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Pyje bunge me pishe te zeze	162.59	10.3	162.59	10.3	0	0.0	0	0.0	0	0.0	0	0.0
Pyje me bunge	400.08	25.4	375.64	23.8	24.44	1.5	0	0.0	0	0.0	0	0.0
TOTALI I Ekonomise	1577.19	100.0	1487.2	94.3	89.93	5.7	0	0.0	0	0.0	0	0.0

IX.5.3 Objektivat specifike silvikulturore

Në lidhje me objektivat silvikulturore për EP Iballe-Mezi, synimi ynë është të ruajmë sipërfaqen pyjore dhe aplikimi i ndërhyrjeve silvikulturore, si pastrimet, rrallimet, prerjet e njepasnjeshme/ perfundimtare etj. Sipërfaqja e përgjithshme e përcaktuar për aplikimin e ndërhyrjeve silvikulturore ne trungshte është **21.82 ha**. Ne trungshte do te aplikohen rrallime tipi 1 dhe rrallime tipi 2 me nje volum total prej **356.55 m³**.

Nderhyrja	Pjesa ekonomike	Parcela	Sip(ha)	Volumi i nxjerre (m3)
<u>Rrallim tipi I</u>	Iballe	41a	2.22	42.18
		41b	1.45	46.3
	Mezi	4a	2.27	111.39
		12a	1.64	38.82
		13a	2.88	53.04
		51a	9.57	64.82
<u>Rrallim tipi II</u>	Iballe	43b	1.79	0
Totali			21.82	356.55

Ne cungshte do te aplikohen clirime, konvertim me mbjellie dhe prerje sanitare duke prekur nje siperfaqe prej **106.6 ha**.

Nderhyrja	Pjesa ekonomike	Parcela	Sip(ha)	Volumi I nxjerre (m3)
-----------	-----------------	---------	---------	-----------------------

Clirim	Iballe	3a	11.7	120	
		5a	6.6	24	
		6a	2.9	36	
		7a	8.3	160	
		10a	4.8	91	
		16a	3.5	40	
		40a	2.4	25	
		40b	1.9	23	
		43a	8.2	135	
		49b	1.8	49	
		62a	3	97	
		63a	1.4	24	
		Mezi	1a	2.9	19
	14a		3.3	59	
	16a		0.9	6	
	18a		0.6	8	
	20a		0.6	6	
	21a		2.7	29	
Totali 1			67.5	951	
Konvertim me amesore		Iballe	49a	6.0	187
Totali 2			6.0	187.0	
Konvertim me mbjellje	Iballe	42a	1.6	17	
		44a	0.7	7	
	Mezi	9a	4.2	70	
		15a	1.2	24	
		17a	4.3	59	
		22a	3.6	0	
		24a	4	108	
		60a	1	20	
		66a	1.1	8	
		90a	5	150	
		94a	2.6	53	
		97a	3.8	74	
Totali 3			33.1	590	
Totali			106.6	1728.0	

IX.5.4 Objektivat specifike për kullotat

Zbatimi i praktikave të kullotjes në përputhje me nevojën e grumbujve pyjorë për t'u ripërtërirë dhe domosdoshmërinë për të ruajtur një mbulesë vegjetacioni të mjaftueshme çon në strategjinë e mëposhtme:

Tipi i përdorimit	Objektivat e mbarështimit	Llojet e aktiviteteve	Masat parandaluese dhe mbrojtëse
Kullotë	- Mbrojtja mjedisore - Ruajtja e zonave të ndjeshme specifike. - Mirëmbajtja e kapacitetit kullosor	- Punime përmirësuese të kullotave: heqje barerash të keqja dhe grumbullim gurësh. - Ndertim 3 lera uji.	- Organizimi i kullotjes racionale - Përfshirja e kullotjes në zonat më të ndjeshme (tokat e erodura, sip. që kanë nevojë për ripërtëritje) Lidhja e kontratave me përdoruesit.

IX.5.5 Objektivat specifike për biodiversitetin

Ruajtja e biodiversitetit aktual dhe përmirësimi i gjendjes së habitateve dhe biotopeve janë objektivat kryesore të këtij plani mbarështimi. Mbarështimi i pyjeve dhe teknikat silvikulturore do i kushtojnë një vëmendje të veçantë arritjes së objektivave të mëposhtme:

- Mbrojtjes,sa më shumë të jetë e mundur,të specieve pionere gjatë shfrytëzimit;
